

Doracak për realizimin e aktivitetit edukativ në institucionet ndëshkuese- përmirësuese

Risto Karajkov dhe Marija Dimitrova

Shkup, prill 2017

Përmbajtja

| | |
|--|-------------------------------------|
| Lista e shkurtesave | Error! Bookmark not defined. |
| Hyrje..... | Error! Bookmark not defined. |
| 1. Edukimi në institucionet ndëshkuese-përmirësuese: e drejta dhe nevoja..... | 9 |
| 1.1. Potenciali transformues në edukim | 9 |
| 1.2. Dokumentet ndërkombëtare dhe rekomandimet për edukim të dënuarve .. | 12 |
| 1.3. Mundësitë edukative në institucionet ndëshkuese në Republikën e Maqedonisë..... | 13 |
| 1.3.1. Drejtimit e realizuara | Error! Bookmark not defined. |
| 2. Drejtimit për realizimin e procesit edukativ në INP..... | 20 |
| 2.1. Hyrje | Error! Bookmark not defined. |
| 2.1.1. Sfidat e kryerjes së edukimit në INP | 23 |
| 2.1.2. Faktorët egzogen dhe resocializimi | 25 |
| 2.2. Dizajni i realizimit të programit edukativ në INP..... | 25 |
| 2.2.1. Edukimi dhe resocializimi | 25 |
| 2.2.2. Periudha e shërbimit të dënimit në të cilën do të kryhet trajnimi | 27 |
| 2.2.3. Ndërlidhja e trajnimeve me kryerjen e detyrave punuese | 28 |
| 2.2.4. Kohë e mjaftueshme për planifikim dhe zbatim | 30 |
| 2.2.5. Nevojat dhe interesat e të dënuarve | 31 |
| 2.2.6. Dizajn përshtatës i procesit edukativ | 32 |
| 2.2.7. Angazhim afat-gjatë..... | 33 |
| 2.2.8. Përgatitja e personelit të rëndësishëm në INP..... | 33 |
| 2.3. Motivimi pjesëmarrësve..... | Error! Bookmark not defined. |
| 2.4. Roli i trajnuesit | Error! Bookmark not defined. |
| 2.4.1. Tejkalimi i kufizimeve të punës në INP | 36 |
| 2.4.2. Strategjitë edukative për punë në institucionet ndëshkuese | 38 |
| Përfundim..... | Error! Bookmark not defined. |
| Bibliografi | Error! Bookmark not defined. |
| Aneks I. Lista e të anketuarve | 51 |

Lista e shkurtesave

| | |
|-------|---|
| INP | Institucioni ndëshkues-përmirësues |
| SHNP | Shtëpia ndëshkuese-përmirësuese |
| IEP | Institucioni edukativo-përmirësues |
| IZHSH | Institucioni për zhvillimin e shoqërisë |
| MASH | Ministria e arsimit dhe shkencës |
| DZS | Drejtoria për zbatimin e sanksioneve |
| UE | Unioni Evropian |
| APM | Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë |
| OKB | Organizata e kombeve të bashkuara |
| PZHKB | Programi për zhvillim i kombeve të bashkuara |

Ky doracak është shtypur në kuadër të projektit: arsim dhe trajnim profesional - Një qasje e re ndaj përfshirjes sociale efektive nga ana e Bashkimit Evropian.

Botuesit
Shoqata Instituti për Zhvillim të Komunitetit (IZHK) - Tetovë
DWW Internacional Gjermani

Për botuesin

drejtor i IZHK-së, Sreten Koceski

Autor

Risto Karajkov

Marija Dimitrovksa

Ekipi i projektit

Sreten Kostić
Alexandra Timosievska
Slavko Kostovski
Stojan Donçevski
Lektor
Daniela Maxhova

Qarkullimi: 412 kopje

"Ky publikim është formuluar me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e autorit dhe ekipit të projektit, dhe në asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Unionit Evropian "

Hyrje

Burgu është një institucion që "sipas definicionit" dënon, dëshpëron, marginalizon, stigmatizon, izolon, amputon një sërë karakteristikash të dëshirueshme shoqërore, si për shembull iniciativën, vetëbesimin, autonominë; në përgjithësi, pengon zhvillimin normal të të dënuarit. Në anën tjetër theksohet se qëllimet e dënimit janë (ri) arsimimi, (ri) socializimi, integrimi, rehabilitimi, pjekuria dhe zhvillimi i personalitetit, në atë mënyrë që nuk do ti përsëris rastet të cilat shoqëria (ligji) i dënon. Si të pajtohen këto dy kundërthënie?

(Macanoviq & Nadareviq 2014 fq.12)

Arsimi paraqet të drejtën e çdo njeriu, duke i përfshirë këtu edhe personat të cilët përshkak të veprave penale, përshkak të shkeljes së normave të caktuara ligjore, u arrestuan. Këtu kryesisht mendohet për të drejtën për arsim të personave të cilët janë në burgim në institucionet ndëshkuese-përmirësuese (INP). Arsimi në këtë rast paraqet një sfidë të veçantë për shkak se ndodhet në një mjedis që imponon rregulla dhe kufizime të cilat jo gjithmonë shkojnë në favor të procesit arsimor dhe përfshin punë me kategori të cenueshëm të njerëzve, të cilët kanë arritje të ndryshme arsimore, nevoja dhe motivim të ndryshëm për arsim dhe trajnim.

Edukimi dhe trajnimi janë një nga komponentat kryesore të procesit të resocializimit, i cili është edhe qëllimi kryesor i shërbimit të dënimit me burg. Në këtë drejtim mund të konstatohet se në Republikën e Maqedonisë ky komponent i procesit të resocializimit është i lënë pas dore në një shkallë të konsiderueshme (pavarësisht detyrimit ligjor për të siguruar arsim fillor dhe të mesëm për personat të cilët e shërbejnë dënimin) dhe madje edhe në vitet e fundit kjo pyetje përsëri u reaktualizua kryesisht përmes iniciativës së jashtme.

Arsimimi nuk është vetëm e drejtë, por edhe nevojë themelore për riintegrim të suksesshëm të burgosurve në shoqëri. Të dhënat mbi nivelin arsimor të të burgosurve në Republikën e Maqedonisë (dhe në shumicën e vendeve evropiane) tregojnë se një pjesë të konsiderueshme të popullsisë në burgje e përbëjnë njerëz me arsim të ulët ose aspak arsim dhe kualifikim, gjë që në mënyrë të konsiderueshme e pengon integrimin e suksesshëm të këtyre njerëzve në shoqëri pasi që të dalin nga burgu. Studimet mbi këtë temë tregojnë se procesi i socializimit është më i suksesshëm poqese shoqërohet me mundësinë e arritjes apo zhvillimit të kompetencave të personave që shërbejnë dënimin me burg.

Megjithatë, edhe në nivel botëror, qasja për arsim të personave që shërbejnë dënim me burg është shumë e kufizuar, në shumë raste edhe nuk ekziston, gjithashtu edhe vëmendje e pamjaftueshme është kushtuar cilësisë së arsimit ekzistues. Kjo ndodh edhe pavarësisht faktit se "arsimi konsiderohet si një parakusht thelbësor për rehabilitimin e suksesshëm dhe riintegrimin social të të burgosurve dhe gjithashtu ju siguron perspektiva për të ardhme pa krim" (Czerwinski, Tania; Konig, Eva; Zaichenko 2014, fq. 5).

Institucionet ndëshkuese-përmirësuese janë duke u përballur me një sfidë të dyfishtë - penale dhe rehabilituese. Gjegjësisht, është e rëndësishme të merret parasysh fakti se dënimi në vetvete ka një efekt të dëmshëm mbi personin, dhe për këtë arsye është e rëndësishme për INP-në që të përpiqet të reduktojë këtë dëm - një mënyrë për të bërë këtë është duke ofruar arsim dhe socializim. Gjegjësisht, arsimi shihet si një balancimin dhe aspekt pozitiv i dënimit. Arsimi dhe trajnimi paraqesin pjesë të rolit rehabilitues të INP-së, në drejtim të "sigurimit të aktiviteteve të strukturuar për të burgosurit të cilat si shkëmbim duhet të mbështesin riintegrimin e tyre të suksesshëm në komunitet pas lirimit" (Drejtoria e Përgjithshme për Arsim dhe Kulturë, 2011 f. 5-6).

Në anën tjetër, organizimi dhe kryerja e aktiviteteve edukative në INP paraqet një sfidë të veçantë, nëse marrim parasysh kufizimet e imponuara nga rrethanat në të cilat mbahet mësimi dhe nevojat specifike bashkë me kufizimet e grupit. Kufizimet në aspektin e lirisë së lëvizjes, përdorimin e metodave të caktuara dhe mjeteve në procesin mësimor, si dhe karakteristikat e grupit – njerëz me gjatësi të ndryshme të dënimit, me nivele të ndryshme të arsimimit dhe kualifikimit, por edhe motive dhe interesa të ndryshme, kërkojnë një qasje që përgjatë organizimit të veprimtarisë arsimore në INP duhet të merren parasysh këta faktorë por edhe qasje që kanë strategji për tejkalimin e barrierave të lartpërmendura. Në këtë drejtim, është e nevojshme të përmendet se edhe pse në vitet e fundit ekzistojnë tendenca për zmadhimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencave në mes të përvojave të ndryshme të ofruesve të arsimit (publik dhe privat) në INP, mundësitë për aplikimin e këtyre përvojave janë të kufizuara, duke pasur parasysh se dizajni i programit të edukimit / trajnimit duhet t'i përshtatet institucionit në të cilën do të kryhet, dhe dallimet janë të mundshme në mes të programeve arsimore në INP-të edhe në të njëjtin shtet.

Në Republikën e Maqedonisë, sigurimi i arsimit fillor dhe të mesëm të individëve të cilët janë duke shërbyer dënimin me burg paraqet detyrim ligjor i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH). Megjithatë, përmbushja e këtij detyrimi ligjor nuk është kryer në mënyrë të duhur e cila është theksuar në raportet e Drejtorisë për Zbatimin e Sanksioneve (DZS) dhe Avokatit të Popullit (AP). Institucionet ndëshkuese-përmirësuese kanë për detyrë dhe mundësi për të ofruar

trajtime për aftësi punuese në vendin e punës, por sipas informacioneve të marrura nga raportet vjetore të DZS-së, dhe të intervistave me përfaqësues të administratës së burgjeve në dy INP-ja, këto mundësi janë shumë të kufizuara dhe shumë institucione ndëshkuese-përmirësuese nuk kanë mjete dhe kushte për realizimin e tyre. Në këtë aspekt, mund të konstatohet se pjesa më e madhe e aktiviteteve edukative janë të siguruara me mbështetjen e donatorëve të organizatave të treta dhe janë afatshkurte, kryhen incidentalisht, pa analizë sistematike të nevojave dhe pa kontinuitet, e cila në mënyrë negative reflektohet në mundësinë që këta programe ta realizojnë qëllimin e tyre. Është e nevojshme që të theksohet se deri më tani nuk është realizuar analizë sistematike e nevojave dhe mundësive për arsim dhe trajnim në shtëpitë ndëshkuese-përmirësuese në vend, dhe as që ekzistojnë programe për monitorim sistematik dhe ofrim të mbështetjes në procesin e riintegrit të këtyre njerëzve në shoqëri pas lëshimit të tyre në liri.

Ky doracak realizohet si pjesë e projektit Arsimit profesional dhe trajnim - Një qasje e re për përfshirjen efektive sociale (Arsimi profesional dhe trajnimi: qasje e re për përfshirjen efektive sociale), zbatuar nga Asociacioni Instituti për Zhvillim të Komunitetit (AIZHK) të Republikës së Maqedonisë dhe DVV Intenacional i Gjermanisë. Qëllimi kryesor i këtij projekti është të krijojë një klimë të favorshme për ri-integrim të lehtë, të shpejtë dhe të qëndrueshëm në shoqëri të personave që kanë shërbyer dënim me burg. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në qoftë se ju e keni parasysh përqindjen e lartë të njerëzve të cilët e përsërisin shkeljen e ligjit (mbi 50% në Republikën e Maqedonisë), duke na drejtuar te problemi ekzistues në sistemin dhe metodat e riintegrit të personave të tillë.

Prandaj, në kuadër të këtij projekti janë hartuar programe të shkrimit dhe leximit (shkrim dhe lexim themelor, gjuhë angleze dhe njohuritë themelore kompjuterike) dhe marrje të arsimit profesional në tri fusha (bukëpjekës, flokëtar dhe kopshtar) për personat të cilët janë duke shërbyer dënimin në burg në INP në Shtip dhe Tetovë. Përvojat hartuesve të programeve, trajnuesve dhe pjesëmarrësve në trajnimet janë të përfshira në doracak. Për nevojat e analizës janë realizuar intervista me 24 pjesëmarrës të projektit (anëtarët e ekipit të projektit, trajnerët, pjesëmarrësit në trajnim, stafi i burgut dhe i administratës). Doracaku kërkon të japë udhëzime që duhet të merren parasysh në hartimin e programeve arsimore në INP, realizimin e mësimdhënies dhe strategjive arsimore përgjatë kryerjes së arsimit / trajnimit në këto kushte të veçanta.

Doracaku përbëhet nga dy pjesë.

Pjesa e parë përmban analiza dhe përvoja për nevojën për arsim dhe trajnim të njerëzve që janë duke shërbyer dënimin me burg dhe bën një shqyrtim të dokumenteve kryesore ndërkombëtare në këtë fushë. Në këtë pjesë analizohen situatat në ofrimin e arsimit dhe trajnimit në INP në Republikën e Maqedonisë.

Pjesa e dytë jep udhëzime në kontekstin specifik dhe faktorët të cilët duhet të merren parasysh përgjatë hartimit të programeve arsimore në INP; roli i aktorëve të ndryshëm në procesin e arsimimit (organizatori i programit arsimor; trajnuesi, pjesëmarrësit, menaxhuesit e burgut dhe personelit tjetër në INP) dhe jep udhëzime të cilët bazohet në literaturë relevante në fushën e andragogjisë, saktësisht andragogjinë penologjike, por edhe nga përvojat e pjesëmarrësve në intervistat e realizuara.

1. Arsimi në institucionet ndëshkuese përmirësuese: e drejta dhe nevoja

1.1. Potenciali transformues i arsimit

Arsimi është një nga të drejtat themelore të njeriut që e mbështet zhvillimin individual dhe socializimin e suksesshëm të personalitetit. Personat të cilët janë duke shërbyer dënimin me burg gjithashtu kanë të drejtën e arsimimit në INP. Ky aspekt i zhvillimit personal nëpërmjet edukimit, potencialit të edukimit, ndihmojnë dhe kontribuojnë në arritjen e një ndryshimi të përhershëm, kjo është ajo që mund të transformojë jetën e të dënuarit pas lëshimit në liri. Për atë shkak edukimi në INP duhet të shihet si "qëllim i fundit në vetvete dhe jo si një mjet për një qëllim" (Czerwinski, Tania; König, Eva; Zaichenko 2014, fq. 12).

Krimi ka pasoja të rënda dhe harxhime jo vetëm për viktimën, por edhe për kryerësin, familjen e tij, shoqërinë e gjerë dhe ekonominë. Në këtë drejtim, mundësitë që INP-ja të ndikojë në mënyrë arsimore dhe edukative në resocializimin e përgjithshëm të të dënuarit, është vendimtare për të "promovuar rehabilitimin e kryerësve të krimeve, duke zvogëluar mundësitë e përsëritjes së shkeljeve të ligjit" (Hawley, Murphy, dhe Souto-Otero 2013 fq.6).

Arsimi dhe trajnimi kanë rol të rëndësishëm, edhe pse shpesh indirekt në proceset e tjera të rehabilitimit në INP. Edukimi dhe trajnimi nuk janë vetëm mënyra që të dënuarit ta plotësojnë kohën, të angazhuar në ndonjë aktivitet, por edhe për të përcaktuar rrugën e përfshirjes së tyre sociale në mënyrë efektive. Gjegjësisht, është e mundshme që shumë prej tyre kanë qenë mjet i përjashtimit social para se të hyjnë në INP, dhe mundësia është e madhe që stigma sociale bashkangjitur kësaj kategorie të qytetarëve do të pengojë integrimin e tyre të suksesshëm edhe pas lëshimit nga burgu. Veprimtaria arsimore që ka për qëllim ta furnizojë të dënuarin me njohuri dhe aftësi, por edhe vlera dhe motivim për sjellje të favorshme sociale, mund të përfaqësojnë një mbështetje të rëndësishme në procesin e ri-integrimit.

Në këtë drejtim, një pengesë kryesore është mungesa e qasjes së mundësive për mësim. Në shumicën e rasteve edukimi dhe trajnimi kryhen në mënyrë sporadike, pa kushte thelbësore rregulluese me pak rëndësi për nevojat aktuale të të burgosurve. Përveç kësaj, mungesa e mbështetjes, koordinimit dhe shpesh rezistenca nga autoritetet përgjegjëse, mungesa e bashkëpunimit në mes të institucioneve dhe struktura e brendshme e INP-së paraqesin faktorë që reduktojnë efektivitetin e arsimit.

Procesi arsimor që bëhet gjithnjë e më i laramanishëm në aspektin e mjeteve, metodave dhe kushteve në të cilat kryhet, bëhet gjithnjë më i hapur dhe më fleksibël, duke i rritur mundësitë për të siguruar arsim cilësor të përshtatur në bazë të nevojave të ndryshme të nxënësve. Në këtë kontekst, INP-ja paraqet mjedis

specifik me sfida që janë të ndryshme nga ato të edukatorëve të cilët janë të ballafaquar në kuadër të arsimit standard formal ose arsimit për të rritur.

Nga njëra anë, arsimi zhvillohet në qendra që rregullisht kanë kapacitete të plota (midis shteteve anëtare të BE-së përfshirja mesatare e kapacitetit të burgjeve është 105% (Hawley et al., 2013), kjo përqindje është edhe më e lartë në Republikën e Maqedonisë), me mundësi të kufizuara të përdorimit të mjeteve arsimore (p.sh. TIK) në një mjedis që është i kufizuar në përgjithësi dhe ku shpesh në mes të burgosurve ka rezistencë për pjesëmarrje në sistemin formal të INP-së, pjesë e së cilës është edukimi. Nga ana tjetër, arsimi në këto institucione vijohet për një popullsi që është tepër heterogjene, e cila përfshin njerëz me prejardhje të ndryshme etnike dhe fetare, nivele të ndryshme arsimore, motivim të ndryshëm dhe gatishmëri për t'u angazhuar në procesin e arsimit.

Megjithatë, pavarësisht sfidave, hulumtimet dhe përvojat e më shumë vendeve tregojnë se investimi në arsimimin e personave që shërbejnë dënimin me burg është me rëndësi të madhe për suksesin e riintegrimin të tyre të mëvonshëm. Në këtë kontekst, sipas një studimi (Hawley et al., 2013) i cili merret me vlerësimin e harxhimeve dhe përfitimeve të arsimit në institucionet ndëshkuese-përmirësuese, përfitimet e edukimit të popullatës së burgosur janë pothuajse dyfish më të mëdha se harxhimet.

Sipas të dhënave për nivelin arsimor të të burgosurve, rreth 3-5% e të dënuarve kanë kualifikime të larta, ndërkohë përqindja e tyre me arsim të ulët është dukshëm më e lartë. Përveç kësaj, vihet re se përqindja e njerëzve që parakohe e kanë braktisur arsimin është dukshëm më e lartë në mesin e popullatës së burgosur në krahasim me mesataren e përgjithshme. Në këtë aspekt, konsiderohet se niveli i ulët arsimor paraqet një nga faktorët kryesorë për perspektivat e pafavorshme për punësimin e personave të cilët janë të lëshuar në liri, por edhe mundësia e përsëritjes së veprës (Hawley et al., 2013, f. 5). Këtu qëndron rëndësia e ofrimit të arsimit, që të fitojnë njohuri themelore dhe aftësi, sidomos me anë të trajnimeve profesionale në burgje.

Në Maqedoni nuk ka hulumtime sistematike për interesimin, nevojat dhe mundësitë për arsim në mesin e personave që shërbejnë dënimin me burg. Megjithatë, sipas përvojës së palëve të interesuara që kanë marrë pjesë në realizimin e trajnimit në INP në Maqedoni, por edhe sipas të dhënave të vendeve të BE-së, tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e popullatës së burgosur është e vetëdijshëm për nevojën e strategjive për riintegrimin e tyre të suksesshëm në shoqëri. Gjegjësisht, sipas të dhënave të Departamentit për biznes, inovacion dhe aftësi të Ministrisë së Drejtësisë së Britanisë së Madhe, shumica e të burgosurve në Britani të Madhe (97%) thanë se ata duan ta ndërprejnë ciklin e recidivizmit, ku theksojnë se faktori më i rëndësishëm që kontribuon në të është patja e punës (68%). Në këtë kontekst, të dhënat treguan se gati gjysma (47%) e të burgosurve

nuk posedojnë ndonjë kualifikim arsimor, në krahasim me 15% të një grupi të ngjashëm moshe në kuadër të popullsisë së përgjithshme, ndërsa 13% të tyre nuk kanë qenë asnjëherë të punësuar (Departamenti për inovacionin e biznesit dhe aftësive 2011 fq. 10). Edhe pse nuk ka dëshmi të forta për atë se niveli i ulët i arsimit dhe kualifikimet e ulëta janë një faktor që kontribuon në shkeljen e ligjit, shumica e të dënuarve nuk kanë aftësitë bazë si shkrim-lexim dhe numërim. Në të njëjtën kohë, në kuadër të tregut gjithnjë e më konkurrues të punës, të dënuarit, më shumë se kurrë, janë nën presion për të fituar aftësi dhe kompetenca relevante për t'i rritur mundësitë e tyre në tregun e punës.

Duke pasur parasysh situatën bashkëkohore në tregun e punës, njerëzit me kualifikime të ulëta kanë më shumë gjasa të përballen me papunësinë; vetëm 1 në 10 vende pune të krijuara në periudhën 2006-2010 është e arritshëm për dikë i cili e ka lënë arsimin para kohe, ndërsa norma e punësimit në mesin e të ulët-kualifikuarve është pothuajse 80% më e ulët se ajo e njerëzve me arsim të lartë (Drejtoria e Përgjithshme për Arsim dhe Kulturë, 2011). Pas burgimit, këta njerëz humben në grupin e të papunësuarve dhe shfrytëzuesve të ndihmës sociale. Andaj është rëndë të përcaktohet deri në cilën masë të burgosurit e dikurshëm kanë mundësi të përdorin diturinë dhe aftësitë për gjetjen e punës. (Avramovska & Schweighöfer 2011, fq.154–155). Do të thotë pavarësisht nga kualifikimet e ulëta, të burgosurit e ndonjëherëshëm përballen me barriera të tjera rrugës drejt punësimit, duke përfshirë mungesën e përvojës së punës, por edhe paragjykimet - që kanë një të kaluar kriminale, është një pengesë e rëndësishme për tregun e punës. Megjithatë, studimet tregojnë se punësimi është ai i cili e ul rrezikun e përsëritjes së shkeljes së ligjit për 30-50% (Drejtoria e Përgjithshme për Arsim dhe Kulturë, 2011).

Përmes krijimit të mjediseve që krijojnë një vend stimulues për mësim dhe proces të përgjithshëm të resocializimit, INP-ja e përmbush misionin e vet - "për të siguruar mbështetje që të dënuarit pozitivisht ta shfrytëzojnë dënimin, ti rrisin mundësitë e punësimit dhe ti ndryshojnë qëndrimet personale dhe perceptimet- duke përfshirë këtu edhe të mund ti shohin reaksionet dhe pasojat e veprimeve të tyre" (Hawley dhe bashkëpunëtorët. 2013 faqe 6). Të gjithë këta faktorë mund të kontribuojnë për të ulur mundësinë e përsëritjes së shkeljes së ligjit.

Në këtë drejtim, arsimi kontribuon në zhvillimin e një ndjenjë të përkatësisë në komunitet, duke ua kujtuar atyre që edhe ata do të jenë pjesë e shoqërisë pas lëshimit të tyre nga burgu. Konstatimi se arsimi në INP duhet të jetë i bazuar në një qasje holistike që do të përmbahet parimeve të arsimit për të rritur, por gjithashtu do të ketë edhe rol resocializues, fillon nga supozimi se "arsimi i burgut mund të kultivojë /të zhvillojë njohuri, aftësi, vlera dhe motivim të nevojshëm për qytetërim pozitiv" (Czerwinski, Tania, König, Eva; Zaichenko 2014 fq.11).

Duke pasur parasysh se largimi nga shoqëria, në përgjithësi, është një faktor i rëndësishëm për kriminalitetin, komponenti resocializues i arsimit në INP ka një

domethënie më të gjerë për shoqërinë në përgjithësi. Përvetësimi i aftësive, si edhe zhvillimi i perspektivave të reja për vendin e tyre në shoqëri mund të ndihmojë që njerëzit të bëhen pjesëmarrës aktivë në komunitetet e tyre, pas shërbimit të dënimit. Përveç kësaj, ka edhe dëshmi (Hawley dhe bashkëpunëtorët. 2013 faq.11) që arsimit dhe trajnimi ndihmojnë për zhvillimin e kapitalit social të të burgosurve.

Njëra ndër dilemat kyçe e cila ju imponohet domenit të arsimit në INP është pjesëmarrja e të dënuarve në procesin arsimor, a duhet të jetë vullnetare apo obligueshme. Imponimi i arsimit si detyrë e obligueshme mund të jetë një mënyrë efektive për zmadhimin e pjesëmarrjes. Sidoqoftë, kjo qasje mund të ketë edhe efekt negativ në motivimin e të dënuarve, veçanërisht tek ata që kanë pasur eksperiencë të këqija nga arsimit formal dhe do të jenë të refuzuar nga rregullat e imponuara në pikëpamje të asaj se si duhet ta kalojnë kohën. Si shtesë, pjesëmarrja vullnetare paraqet princip dhe supozim bazë në arsimimin e të rriturve dhe veçanërisht ky aspekt e dallon nga paradigmat e tjera arsimore, e cila është edhe rekomandim nga ana e Asociacionit Evropian të arsimit për të rriturit nëpër burgje (Asociacioni Evropian i të Rriturve në Burgje) (Drejtoria Gjenerale për Arsim dhe Kulturë, 2011, fq.5).

1.2. Dokumentet ndërkombëtare dhe rekomandimet për arsimin e të dënuarve

Këshilli Evropian ka sjellur ca rekomandime që kanë të bëjnë me të dënuarit. Këtu numërohen *Rekomandimet për arsim në burgje prej 1990* (Këshilli i Evropës, 1990) dhe *Rregullat Evropiane për burgjet* (Këshilli i Evropës, 2006), të cilët trajtojnë të drejtën e të dënuarve për arsim. Sipas rekomandimeve ... "Të gjithë të dënuarit duhet të kenë qasje në arsimim, i cili përbëhet nga lëndët arsimore, arsim profesional, aktivitete krijuese dhe kulturore, edukim fizik dhe sportiv, edukim social dhe biblioteka" (Këshilli i Evropës, 1990 fq.1) .

Në përputhje me Rregullat Evropiane të burgjeve, burgjet duhet të sigurojnë qasje në programet arsimore duke marrë parasysh nevojat individuale dhe aspiratat e të dënuarve. Prioritet u jepet të dënuarve të cilët nuk dinë shkrim-lexim dhe ata që nuk kanë asnjëfarë lloji arsimit profesional. Arsimit duhet të ketë të njëjtin status si edhe angazhimi i punës, të dënuarit nuk duhet të jenë të dëmtuar finacialisht ose në ndonjë mënyrë tjetër me pjesëmarrjen e tyre në programin arsimor; arsimit duhet të jetë i integruar me sistemin arsimor dhe vokacional të vendit në mënyrë që të dënuarit mund të vazhdojnë arsimimin dhe trajnimin e tyre pas lëshimit në liri (Këshilli i Evropës 2006 fq.15-16).

Ky model është ndërtuar kryesisht rreth idesë ku të dënuarit shihen si një individ e jo si "shkelës/kriminel" në përputhje me qasjen e arsimit për të rritur (Drejtoria e Përgjithshme për Arsim dhe Kulturë, 2011). Shtojca e Rezolutës së Këshillit për ripërtirjen e agjendës Evropiane për arsimin e të rriturve i fton shtetet anëtare që të fokusohen në "përmbushjen e nevojave mësimore të ... njerëzve në kushtet specifike të ciët janë të përjashtuar nga mësimi, të tilla si ato në burgje ... duke ju siguruar udhëzim dhe mbështetje të duhur" (Këshilli i Evropës, 2011, fq. C 372/6)

Ngjashëm, standardet për të drejtat minimale për trajtimin e të dënuarve (Të drejtat minimale standarde për trajtimin e të burgosurve) të OKB –së (Konferencat e Specjalizuara të Kombeve të Bashkuara) trajton rëndësinë e arsimimit dhe trajnimit për të gjithë të dënuarit si dhe *Parimet themelore për trajtimin e të burgosurve* (Parimet Themelore për Trajtimin e të Burgosurve) në vitin 1990 (Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, 1991) që përfshin udhëzime specifike mbi të drejtat e të dënuarve që ata të jenë të përfshirë në arsim dhe aktivitete kulturore përgjatë shërbimit të dënimit me burg.


1.3. Mundësite arsimore në institucionet ndëshkuese-përmirësuese në Republikën e Maqedonisë

Në Maqedoni ekzistojnë dy lloje të institucioneve ndëshkuese-përmirësuese: shtëpitë ndëshkuese-përmirësuese (SHNP) dhe burgjet. Në vendin tonë funksionon një rrjet prej 11 institucioneve ndëshkuese-përmirësuese (3 shtëpi ndëshkuese-përmirësuese dhe 8 burgje) dhe 2 institucione edukativo- përmirësuese në të cilën kryhet masa e drejtimit në shtëpinë edukativo-përmirësuese. Personat e dënuar të gjinive të ndryshme, dënimin e shërbejnë në hapësira të ndryshme. Në këtë drejtim, duke pasur parasysh përqindjen më të ulët të të dënuarve femra në popullatën e të burgosurve (3.4% sipas të dhënave nga Drejtoria për zbatimin e sanksioneve, 2016), vetëm në INP Idrizovë ka një njësi të veçantë për femrat që janë të dënuara me burgim pavarësisht nga gjatësia e dënimit.

Në nivel kombëtar ekzistojnë tetë institucione të tipit gjysmë të hapur /mbyllur edhe atë si vijon: burgu në Manastir, burgu në Gjevgjeli, burgu në Kumanovë me një njësi të hapur në Kriva Pallankë, burgu në Prilep, burgu në Shkup, burgu në Strumicë, burgu në Tetovë si dhe burgu në Ohër (i cili funksionon si një institucion ku kryhet shërbimi me burg për të mitur). Në këto institucione (me përjashtim të burgjeve në Strumicë) janë themeluar njësi të paraburgimit në të cilën kryhen masat e paraburgimit për meshkuj dhe femra (Strategjia nacionale për zhvillimin e sistemit penitenciar (2015 në 2019) 2014)


Sipas raportit vjetor të Drejtorisë për zbatimin e sanksioneve (C & N), numri i përgjithshëm i personave që shërbejnë dënimin me burg në institucionet ndëshkuese-përmirësuese në Republikën e Maqedonisë është 3 087 (situata në 31.12.2015), e cila është për 2.35% më shumë se sa në vitin 2014 (Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, 2016).

Figura 1. Pasqyrë e numrit të dënuarve që shërbejnë dënimin me burg në të gjitha institucionet ndëshkuese-përmirësuese nga 31.12.2015, sipas nivelit të arsimit (Drejtoria për zbatimin e sanksioneve, 2016):



Sipas të dhënave nga grafikoni 1 mund të konkludohet se ekziston një përfaqësim disproporcional të njerëzve me arsim të ulët ose pa arsim në kuadër të popullatës së burgosur. Gjegjësisht, përqindja kumulative e personave pa dhe me arsim fillor të kompletuar e tejkalon gjysmën e popullatës së burgosur. Prandaj, jo-realizimi i detyrimeve ligjore lidhur me sigurimin e arsimit fillor dhe të mesëm të detyrueshëm të njerëzve në INP, në mënyrë të konsiderueshme e zvogëlon mundësinë për ri-integrimin e tyre të suksesshëm në komunitet.

Figura 2. Struktura e të dënuarve sipas moshës, situatës prej 31.12.2015 (Drejtoria për zbatimin e sanksioneve, 2016)



Përveç kësaj, të dhënat e paraqitura në Figurën 2 tregojnë se numri i të dënuarve – të kthyerve është gjithashtu i lartë. Megjithatë, fakti se shumica e të burgosurve janë më të ri (të moshës deri në 40 vjet), shënon edhe mundësi më të mëdha për arsimim dhe resocializim me më shumë gjasa për sukses.

Akti themelor që e definon ekzekutimin e sanksioneve të shtetit është ligji mbi zbatimin e sanksioneve, në të cilën përgjithësisht janë marrë parasysh standardet ndërkombëtare për zbatimin e dënimit me burg (Këshilli i Evropës, 2006; Konferencat e Specjalizuara të Kombeve të Bashkuara, 1955), e cila është një parakusht për respektimin e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të të dënuarve.

Drejtoria për Zbatimin e Sanksioneve (DZS) është një institucion me një mandat për të koordinuar zbatimin e sanksioneve dhe organizimin profesional si dhe menaxhimin me institucionet ndëshkuese-përmirësuese dhe institucionet edukativo-përmirësuese në vend. Në vitin 2010 është themeluar Komisioni shtetëror për ekzekutimin e sanksioneve, si një trup me mandat për të mbikëqyrur punën e INP-së, megjithatë e njëjta nuk funksionon, deri tani nuk ka realizuar asnjë mbikëqyrje në institucionet. Nga raportet e DZS-së është evidente mungesa e bashkëpunimit në mes të institucioneve, duke përfshirë këtu edhe fushën e arsimit

Nga raportet e DZS-it dhe APM, si dhe nga analizat e kryera për nevojat e planifikimit strategjik në fushën e sistemit penitenciar, shihet nga konkluzioni se ka më shumë pengesa për zbatimin e suksesshëm të arsimit dhe trajnimit të popullsisë së burgosur. Një nga problemet kryesore është mungesa e kapacitetit hapësinor. Gjegjësisht, sistemi i burgjeve në vend për shumë vite u përball me problemin e mbipopullimit, ku ky problem është më akut në Institucionin Korrektues në Idrizovë.

Në përgjithësi, mbipopullimi i mjediseve të strehimit është një problem që përballen të gjitha burgjet në vend, i cili është rasti me shumicën e vendeve evropiane.

Sipas Raportit Vjetor të Statistikave Penale të Këshillit të Evropës në vitin 2010, popullsia e burgjeve në nivel nacional është rritur me mbi 76% në periudhën 2000-2009 (Strategjia Kombëtare për Zhvillim e sistemit penitenciar (2015 në 2019) 2014). Ky trend i zmadhimit të numrit të popullsisë në burgje është i pranishëm edhe në vendet e tjera evropiane dhe zakonisht interpretohet si rezultat i rritjes së krimit dhe rritjes së zbulimit të veprave penale.

Sipas Rregullave Evropiane të Burgjeve (Këshilli i Evropës, 2006), secili burg duhet të përpiqet që të gjithë të dënuarit t'u mundësojë qasje në arsimim më gjithëpërfshirës që t'i plotësojnë nevojat dhe preferencat e tyre individuale. Në këtë kontekst, përparësi kanë ata të burgosur që janë analfabetë ose që nuk kanë arsim bazë apo arsim vokacional. Edukimi i të burgosurve duhet të "integrohet në sistemin arsimor të shtetit me qëllim, që pas lëshimit nga burgu të mund lehtë të ta vazhdojë arsimin, gjegjësisht të zbatohen nën kujdesin e institucioneve arsimore jashtë burgut" (Këshilli i Evropës 2006 fq.15-16).

Përgjatë Rregullave Evropiane të burgjeve dhe Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve¹ Ligjit për arsim fillor² dhe Ligjit për arsimin e mesëm³ që rregullojnë të drejtën e arsimimit të të burgosurve. Sipas legjislacionit, në shtëpitë ndëshkuese-përmisuese obligueshëm organizohet arsimi si pjesë e sistemit të tërërsishëm të arsimimit dhe edukimit. Arsimimi i të burgosurve mund të organizohet në vetë institucionin ose në vendin e selisë së institucionit.

MASH ka përgjegjësi për organizimin dhe financimin e arsimit fillor për të burgosurit sipas propozimit të DZS. Sipas raporteve të DZS-së në shtëpitë ndëshkuese-përmirësuese në vend janë krijuar kushte për funksionimin normal të procesit arsimor të të burgosurve, megjithatë ajo është zbatuar vetëm në INP në Idrizovë. Në institucionet e tjera nuk realizohet procesi arsimor (Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e sistemit penitenciar (2015 në 2019) 2014). Raportet e DZS-së theksojnë se bashkëpunimi me MASH është i pakënaqshëm, për arsye se "nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nuk sigurohet stafi i nevojshëm dhe burime për zbatimin e procesit arsimor në institucionet ndëshkuese-përmirësuese dhe IEP në Republikën e Maqedonisë" (Ministria e Drejtësisë 2010 , fq.14). Në vitin 2009, Ministria e Arsimit dhe Shkencës filloi një iniciativë që duhet të mbështesë

¹ Ligji për zbatimin e sanksioneve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 2 nga 9.1.2006), 2006.

² Ligji për arsimin fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08 од 19.8.2008), 2008.

³Ligji për arsimin e mesëm teksti i konsoliduar („Gazeta Zyrtare e RM nr. 44/1995; 24/1996; 34/1996; 35/1997; 82/1999; 29/2002; 40/2003; 42/2003; 67/2004; 55/2005; 113/2005; 35/2006; 30/2007; 49/2007; 81/2008; 92/2008; 33/2010; 116/2010; 156/2010; 18/2011; 42/2011; 51/2011; 6/2012; 100/2012 dhe 24/2013)

dhe ndihmoj arsimin fillor për çdo të dënuar, por për shkak të mungesës së fondeve projekti nuk u zbatua.

Edukimi në bazë të profesionit zbatohet në të gjitha institucionet ndëshkuese-përmirësuese, por spektri i aktiviteteve me të cilat realizohen trajnimet për të dënuarit dhe të miturit është i kufizuar. Ka një mungesë në verifikimin formal të të dënuarve për profesionet e fituara dhe aftësitë nga ana e institucioneve relevante (Strategjia kombëtare për zhvillimin e sistemit penitenciar (2015 në 2019) 2014), i cili është me rëndësi të madhe për mundësinë e të dënuarve që të ju njihet kualifikimi në tregun e punës.

Në të njëjtën kohë, raportet e DZS-së thonë se në institucionet në të cilët shërbehet dënimi me burg për një kohë më të shkurtër "nuk ka mundësi reale për përfshirjen e të dënuarve me dënime afat shkurtër në proceset klasike arsimore shkollore," por edhe ekziston "nevoja për të futur një model të ri për arsim dhe edukim të të burgosurve për zbulimin e të cilit do të na shërbejnë përvojat komparative dhe praktikat pozitive nga vendet e tjera "(Strategjia kombëtare për zhvillimin e sistemit penitenciar (2015-2019), 2014 f.25). Në këtë kontekst, është e qartë se tani ka mungesë të përpjekjeve për krijimin e mundësive arsimore më fleksibile që do t'i plotësojnë nevojat e kategorive të ndryshme të të dënuarve.

Nga ana tjetër, analiza e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për situatën e sistemit të burgjeve në vendin tonë shfaqin një normë shqetësuese të rritjes së të kthyerve në institucionet ndëshkuese-përmirësuese, si edhe rritjen e numrit të të dënuarve që abuzojnë me drogë apo alkool, që "tregon shkallën e efikasitetit të sistemit të ekzekutimit të sanksioneve dhe nëse ai i njëjti e realizon qëllimin e vet kryesor - resocializimin dhe adaptimin social" (Ministria e Drejtësisë 2010, fq.9). Gjegjësisht, rritja e shkallës së të kthyerve na çon në një përfundim se ka një problem në sistemin e resocializimit (ku merr pjesë edhe arsimi) në INP⁴. Një shqetësim tjetër është fakti se deri tani nuk janë marrë asnjefarë lloj aktivitete për revizion dhe reforma të këtij sistemi. Në këtë kontekst, mund të supozohet se neglizhimi i arsimit, zhvillimi i njohurive dhe aftësive të të dënuarve, gjendja e të cilëve është, ndër të tjera, si rezultat i përjashtimit social (e cila është edhe rezultat i edukimit), pamundëson INP-ja në mënyrë adekuate të përmbush misionin e saj dhe të mbështet riintegrimin e suksesshëm të të dënuarve në shoqëri.

Kur është fjala për ekzistimin e kushteve për realizimin e procesit arsimor të të burgosurve, raportet nga ana e Avokatit të Popullit dhe DZS tregojnë se në një numër të vogël të institucioneve ekzitojnë kështu hapësira, edhe pse ka disa përpjekje për organizimin e arsimit fillor për popullatën e burgosur (Ministria e Drejtësisë 2010 , fq.12).

⁴ Shkalla e recidivimit është e lartë dhe lëviz rreth 55 % e popullatës së burgjeve (*Strategjia kombëtare për zhvillimin e sistemit penitenciar (2015-2019), 2014*)

Angazhimi me punë i të dënuarve është i organizuar brenda dhe jashtë institucioneve ndëshkuese-përmirësuese. Kjo bëhet në bazë të pajtimit paraprak të dënuarit për punën që duhet të jenë të angazhuar. Shumica e të dënuarve që janë të angazhuar me punë janë me trajtim të hapur ose gjysmë të hapur, ndërsa të burgosurit në njësitë e mbyllura pothuajse nuk janë të angazhuar me punë. Në përgjithësi, në institucionet ndëshkuese-përmirësuese nuk ka një spektër të gjerë të aktiviteteve në të cilat të dënuarit mund të angazhohen me punë. Përveç kësaj, pajisjet që ata i kanë në dispozicion janë të vjetëruara dhe nuk korrespondojnë me teknologjinë moderne (*Strategjia kombëtare për zhvillimin e sistemit penitenciar (2015 në 2019) 2014*)

Arsimi si një qëllim, ende është i pranishëm në dokumentet strategjike të Ministrisë së Drejtësisë. Në këtë drejtim, analiza e dokumenteve ekzistuese, është evident angazhimi për përmbushjen e detyrimit ligjor për arsim fillor dhe të mesëm, por edhe mundësia që procesi arsimor të jetë subjekt i akreditimit (Ministria e Drejtësisë, 2010; *Strategjia Kombëtare për zhvillimin e sistemit penitenciar (nga 2015 deri në vitin 2019) 2014*). Për shkak se angazhimet strategjike janë në proces të realizimit, deri tani nuk mund të bëhet vlerësim i shkallës së realizimit të tyre, efektivitetit dhe ndikimit të përgjithshëm

Pjesa më e madhe INP-së përballlet me probleme financiare që i vënë përpjekjet arsimore në plan të dytë. Për shembull, sipas raportit të Avokatit të Popullit për vitin 2016, burgu në Tetovë prej viteve më parë ka probleme buxhetore, të cilat ndikojnë në sigurimin e kushteve normale të jetesës, por edhe realizimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve, duke e përfshirë edhe të drejtën për arsim. Në këtë aspekt, raporti sjelli në pah se "Burgu nuk ka mundësi për seminare në të cilët do të realizoheshin aktivitete ekonomike-mësimore, dhe në to nuk kryhet as edhe procesi arsimor" (Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, 2016a, stp.58).

Në repartin e femrave të SHNP-së në Idrizovë nuk ka asnjë formë të edukimit të rregullt, gjegjësisht, nuk përmbushet detyrimi për sigurimin e arsimit të obligueshëm fillor dhe të mesëm. Kjo është e rëndësishme sepse sipas të dhënave të DZS-së për vitin 2015, nga 94 të dënuar që janë duke shërbyer burgun e Idrizovës, 18 prej tyre, ose gati një e pesta nuk kishte aspak arsim (Drejtoria për zbatimin e sanksioneve, 2016). Raporti special i APM arriti në përfundimin se ky institucion nuk ka organizuar ndonjë trajnim profesional të të dënuarve, dhe është në kundërshtim me nenin 39 të Rregullores së shtëpisë së institucionit, sipas të cilës, "rregullat e përgjithshme për institucionin dhe për trajnimin profesional në institucion janë të tilla që institucionet mund të organizojnë edhe forma të veçanta të trajnimit profesional të të dënuarve për marrjen e kualifikimeve të caktuara ose kurse, seminare dhe trajnime të tjera" (Avokati i Popullit të Republikës së Maqedonisë, 2016b, fq. 27)

Një pengesë shtesë paraqet edhe mungesa e kontinuitetit në procesin e resocializimit dhe edukimit, si rezultat i bashkëpunimit të pamjaftueshëm dhe në disa raste edhe tërësisht jo-ekzistent në mes të institucioneve ndëshkuese-përmirësuese dhe shërbimet sociale. Të burgosurit e liruar duhet të mbajnë kontakt me punonjësin social të cilët më parë janë të njohur me të kaluarën e ish-të dënuarit. Arsimi i filluar shpesh ndërpritet, poqese i dënuari është i zhvendosur në një institucion ndëshkues-përmirësues tjetër apo i lëshuar në liri. Deri më tani nuk ka aktivitete për mbështetjen e kontinuitetit të arsimit për të burgosurit që janë lëshuar në liri.

1.3.1. Projekte të realizuara

Pjesa më e madhe e aktiviteteve edukative dhe trajnimeve profesionale në INP në vend realizohen sipas iniciativës dhe me përkrahjen e organizatave të sektorit civil. Megjithatë, këto iniciativa janë të rralla, dhe mungesa e kontinuitetit ka një ndikim të dëmshëm mbi efektivitetin dhe ndikimin e këtyre iniciativave. Në dekadën e fundit, janë të realizuara disa programe arsimore dhe trajnime për aftësim profesionale të mbështetur nga DVV Internacional, UNDP, në bashkëpunim me DZS dhe MASH.

Në vitin 2008, DVV Internacional në bashkëpunim me burgun e Tetovës realizoi një projekt për trajnimin e të dënuarve. Në fazën përgatitore të projektit paraprinte një analizë e nivelit të njohurive dhe të nevojave për trajnim të të dënuarve. Në kuadër të projektit u realizuan pesë kurse trajnuese për të dënuarit. Si rezultat i aktiviteteve të projektit, total prej 24 të burgosur kanë fituar kompetenca kyçe në fushën e aplikimeve kompjuterike dhe gjuhëve të huaja.

Për shkak të interesit të madh në mesin e të dënuarve, por edhe menaxhuesve të burgut në vitin 2010 janë organizuar trajnime në të njëjtat fusha për 22 të dënuar shtesë. Është e rëndësishme të theksohet se në kuadër të kurseve kanë qenë të integruara edhe tema të tjera, si për shembull, përmbajtje në lidhje me kujdesin shëndetësor, me ligjërata nga ekspertë dhe shfaqje filmash në tema të ndryshme: SIDA, parandalimi i hepatitit, tuberkulozit dhe parandalimi i drogës. Trajnimet janë mbajtur në dhoma të veçantë vetëm për atë qëllim, rinovuar dhe pajisur me disa kompjutera, tavolina, karrige, dhe materiale të nevojshme. Të dënuarit kanë mund të përdorin dhomën dhe kompjuterat edhe gjatë kohës së lirë (Avramovska & Schweighofer 2011 fq.153-154)

Në periudhën 2016-2017 UNDP-ja në bashkëpunim me MASH dhe DZS ka organizuar trajnime për arsimim profesional për të dënuarit në burgun në Kumanovë. Total 45 të burgosur kanë mundësi të marrin pjesë në trajnim për argon saldator apo bukëpjekës. Nga të dhënat në dispozicion, mund të konkludohet se

shumica e programeve janë thelbësisht të përshtatura me kushtet specifike në INP dhe janë kryesisht trajnime për njohuri dhe aftësi themelore. Në këtë aspekt, në plan të dytë janë nivelet e ndryshme të arsimit dhe kualifikimet e të dënuarve. Përveç kësaj, andragogjia penologjike është e pazhvilluar dhe e pranishme te ne, kështu që trajnimet kryhen nga njerëz me përvojë të andragogjisë, pa përgatitje paraprake për kushtet dhe specifikat e grupit të synuar.

Projektet e realizuara u ndoqën me interesim të madh nga ana e të burgosurve, por edhe bashkëpunim dhe interesim nga ana e institucioneve relevante dhe menaxhuesit e INP-ve. Megjithatë, duhet të theksohet se shkurtësia e programeve, mungesa e kontinuitetit në zbatimin e veprimtarisë arsimore, dhe mungesa e një sistemi për mbështetjen e të dënuarve në vazhdimsinë e arsimit / trajnimit pas lëshimit nga burgu, nuk do të sjellë një zgjidhje përfundimtare për problemin e arsimit dhe trajnimit në INP. Në këtë kuptim, nuk ekzistojnë analiza në cilin nivel programet e realizuara janë në përputhje / e mbështesin programin për resocializim (dhe me çfarë) dhe cilat elemente edukative i kanë në dispozicion. Pjesa më e madhe e të dënuarve përballen me pengesa të mëdha në lidhje me qasjen e tyre në tregun e punës edhe kur ata janë të dedikuar për t'u ndryshuar. Në këtë drejtim, trajnimet për aftësi profesionale duhet të përfshijnë edhe elemente të edukimit social, dhe të njëjtit do të mundësojnë të dënuarve që më lehtë t'i tejkalojnë pengesat dhe stigmën pas lëshimit në liri.

2. Drejtimet për realizimin e procesit arsimor në SHNP

2.1. Hyrje

Të burgosurit janë ndër grupet më të përjashtuara në shoqëri. Shumë prej tyre e ka gjetur veten në ato rethana si rezultat i marginalizimit dhe përjashtimit social në baza të ndryshme; në anën tjetër, "vetë akti i mbylljes, fizikisht, shoqërisht dhe psikologjikisht i ka larguar nga shoqëria" (Costelloe 2015 f.31). Në të kaluarën, zhvillimi i praktikave të mira, metodologjive dhe materialeve për arsim në burgje është udhëhequr kryesisht nga vetë praxa dhe është kryer në nivel të institucioneve individuale. Si rezultat i kësaj, inovacionet dhe përvojat nga një institucion rrallë shkëmbehen me kolegët që punojnë në burgje të tjera ose vende të tjera. Kjo do të thotë që "edukatorët të cilët janë për arsimim në burgje apo ata që përpiqen që të aplikojnë qasje dhe programe të reja janë shpesh të dënuar për të "shpikur rrotën" (Drejtoria e Përgjithshme për Arsim dhe Kulturë, 2011 fq.16). Megjithatë, kohëve të fundit ka përpjekje për të tejkaluar këtë qasje dhe bashkëpunim më të madh si dhe shkëmbim të përvojave në mes të palëve të interesuara.

Përgjatë dizajnimin të procesit arsimor në INP, është e nevojshme për të bërë dallime të caktuara. I pari ka të bëjë me përcaktimin e arsimit. Në fakt, ky përcaktim mund të ketë rëndësi kyçe për mënyrën se si do të rjedh dhe zhvillohet ky lloj procesi arsimor. Shembuj nga vendet evropiane tregojnë për faktin se ka koncepte të ndryshme të arsimit. Për shembull, në disa vende shumica e aktiviteteve që lidhen me punën janë të shënuara si arsim, ndërsa në vende të tjera vetëm intervenimet specifike të drejtuara nga sjellja e të burgosurve konsiderohen si arsim, ndërsa vende të treta mbahen programe arsimore të cilat janë të përshtatura / apo nuk janë të përshtatura me kontekstin e burgut (Czerwinski, Tania, König, Eva; Zaichenko 2014 fq.9). Në këtë aspekt, të gjitha përpjekjet për të shqyrtuar praktikat e ndryshme duhet të fillojnë nga definicionet e ndryshme me qëllim që të mirren parasysh supozimet e tyre.

Në shumicën e vendeve, ajo që nënkuptohet si arsim ndërlidhet me trajnimin / trajnimin e punës. Edhe pse trajnimi nuk është më pak i rëndësishëm se arsimi, është e dëshirueshme që të dyja të ndërlidhen. Në këtë drejtim, në qoftë se qëllimi i edukimit në INP është që të zhvillojë kapacitetet e të burgosurve që në mënyrë kritike të rikthehen mbi "vlerat e tyre dhe në mënyrë të përshtatshme të transformojnë aktivitetet e tyre të ardhme, në atë rast shumë prej programeve ekzistuese me vlerë të lirë dhe programeve të punësimin nuk takojnë në arsim ashtu siç është i definuar në fushën e arsimit pët të rritur ose "arsimit të burgut" ashtu siç e nënkupton Këshilli i Evropës dhe organet e tjera "(Czerwinski, Tania, König, Eva; Zaichenko 2014 f.11). Në shumë vende programet e tilla shihen si zëvendësues i cili është më i drejtëpërdrejtë dhe efikas në aspektin e shpenzimeve. Megjithatë, në rrethana të caktuara, trajnimet e tilla mund të jenë një zëvendësim i mirë në mungesën e ndonjë aktiviteti tjetër arsimor në INP.

Duke marrë parasysh të lartëpërmendurën, edhe kur bëhet fjalë për trajnim profesional, trajnimi nuk duhet të jetë i kufizuar vetëm për mësimin e zanateve dhe aftësive të të caktuara, por duhet të përfshijë edhe aftësimin e të dënuarit që të përballet me problemet dhe situatat e reja, si në burg ashtu edhe në liri. I dënuari përgjatë arsimit pranon një sërë njohurish që janë të nevojshme për të krahasuar pikëpamjet e tyre personale me ata pikpamje që janë të pranuar nga shoqëria. Në këtë mënyrë arsimi bëhet mjeti kyç në procesin e riprodhimit shoqëror, por edhe mbështetje për zhvillimin personal të individit. Përgjatë procesit të arsimimit në mesin e të burgosurve zhvillohen aftësitë punuese, "intelektuale, sociale dhe psikofizike. Ndryshimet në fushën kognitive ndikojnë në sferën afektive; të dënuarit bëhen më pak të shqetësuar, më pak impulsiv, më bashkëpunues dhe tolerant në komunikim vertikal dhe horizontal, i ndryshojnë qëndrimet e tyre rigide, idetë dhe mendimet" (Macanović & Nadarević 2014 fq.125).

Në fakt, procesi i suksesshëm arsimor inicion ndryshime në stilin e jetesës së të dënuarit, i cili shpesh është shkaku, ose të paktën një nga shkaqet e veprimtarisë

kriminale; kontribuon në plotësimin e kohës së lirë të të dënuarit dhe kontribuon për mundësi më të mira dhe më të mëdha për punësim, e ngre vetëdijen e tij për veten dhe e mbështet zhvillimin e tij personal në tërësi, duke ia lehtësuar që në mënyrë të pavarur të zgjidh problemet personale dhe problemet në rrethin e tij të afërt.

Ky komponent transformues i arsimit, përpjekja që personaliteti të ri-edukohet, të fitojë vlera dhe norma të reja të sjelljes mund të ndikojë negativisht në motivimin e grupit për të mësuar. Në një përpjekje për të bërë burgun ambient që mbështet të mësuarit, është me rëndësi që të merren parasysh edhe pikëpamjet e vetë të dënuarve në lidhje me arsimin. Në këtë pikëpamje, shumë ekspertë theksojnë se veçanërisht këto pikëpamje janë kyçe për pjesëmarrjen e të dënuarve në programin e arsimit dhe trajnimit. Për shembull, rezultatet e një studimi të kryer në mesin e femrave të burgosura në Bullgari, treguan se problemi me interesimin e ulët për arsim shtesë buron nga sistemi i vlerave të tyre për shkak se shumë prej pjesëmarrëseve në hulumtim, arsimit thjesht "nuk është një nga prioritetet e jetës së tyre" (Drejtoria Përgjithshme për Arsim dhe Kulturë, 2011 fq.11).

Nga ana tjetër, roli i arsimit në burg është e sidomos i theksuar për shkak të deficitit arsimor, përshkak të përgjithsisht nivelit të ulët të kompetencës në mes të popullsisë së burgjeve. Në këtë drejtim, edukimi të dënuarit duhet që t'i ofroj "edhe argëtim edhe njohuri" me qëllim që ti motivojë ata që të angazhohen në procesin e edukimit / trajnimit.

Problemi i arsimit dhe risocializimit të dënuarve është një problem multidisiplinar, me atë merren penologjia, andragogjia, psikologjia, sociologjia, psikologjia sociale, patologji sociale, kriminalistika, shkencat politike, studimet e sigurisë, të ligjit, etj (Macanović & Nadarević 2014). Nuk ka pothuajse asnjë shkencë sociale nga e cila andragogjia penologjike nuk tërheq njohuri dhe i përshtat ata për nevojat e veta të korrigjimit të lëndës.

Në INP në procesin e arsimit marrin pjesë të rritur, që në krahasim me fëmijët dhe të rinjtë, hyjnë në procesin e arsimit me një bazë të akumuluar të përvojave dhe njohurive të jetës. Ata marrin pjesë në procesin arsimor me shprehje të fituara, qëndrime dhe paragjykime të mundshme që mund të ndikojë negativisht në procesin e të mësuarit.

Në këtë drejtim, nxënësit e rritur kanë nevojë më të madhe që ta kuptojnë qëllimin e procesit mësimor, si dhe të binden për përfitimet praktike nga njohuritë dhe aftësitë e reja. Ata kanë nevojë të përfshihen në mënyrë aktive dhe të ndikojnë në procesin e të mësuarit, që të ketë një zgjedhje në të mësuarit dhe mënyrën e të mësuarit (AKPM 2011). Përveç kësaj, ka dallime në burimet dhe nivelin e motivimit të nxënësve të rritur në krahasim me fëmijët / të rinjtë. Të gjitha këto karakteristika duhet të merren parasysh në hartimin e aktiviteteve për arsimin e të rriturve me qëllim që të optimizohet efekti edukativ.

2.1.1. Sfidat për krerjen e arsimit në INP

INP-ja është një mjedis që përcakton një varg kufijsh dhe sfidash për rjedhjen e suksesshëm të procesit arsimor. Këto sfida janë shumëdimensionale dhe i referohen "profilit të ndryshëm të të burgosurve dhe profilit që është gjithnjë në ndryshim; nevoja për t'u mbajtur hap pas hapi me ndryshimet në arsim dhe trajnimin standard; si dhe adoptim të teknologjive të reja mësimore, që paraqet një sfidë të veçantë për sa i përket çështjes së sigurisë në mjedisin e burgut" (Hawley et al., 2013 fq.6).

Procesi arsimor në këto institucione zhvillohet nën ndikimin e disa faktorëve: rutina e burgut, rregullat e sigurisë, marrëdhëniet midis shërbimit të burgut, trajnuesit dhe të burgosurit etj. Arsimi në burgje është subjekt i një diapazoni të gjerë pengesash nga natyra organizative dhe edukative. Këto përfshijnë qëndrimin e autoriteteve të burgut për vijimin e procesit arsimor dhe (mungesa e) mbështetjes, bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm në institucion, situata në vet objektet, sa është trajnuesi i përgatitët, madhësia e burgut dhe kapaciteti i mbushjes, si dhe kualifikimet dhe nivelet arsimore e të dënuarve. Trajnuesit duhet të punojnë në kuadër të dënimit me burg të nxënësve, e cila mund të ndryshojë nga disa muaj deri në burgim të përjetshëm. Si shtesë, shkalla e lartë e problemeve psikike/ çrregullime në mesin e të burgosurve dhe varësia nga alkooli dhe droga paraqesin sfida shtesë për mbarëvajtjen e arsimit në kushtet e burgut (Rogers, Simonot, dhe Nartey 2014 fq.10-11).

Të burgosurit çdo ditë gjenden në ndërveprim me stafin e burgut, me organizim formal të institucionit, me regjimin e tyre dhe sistemin normativ. Të gjithë ata paraqesin kornizën e jashtme në të cilën krijohen dhe zhvillohen marrëdhëniet joformale me të burgosurit. Ndikimi i përbashkët i këtyre dy sistemeve, formale dhe joformale, rezulton në një tendencë të vazhdueshme për ndikim të ndërsjellë, shtypje dhe neutralizim.

Në këtë drejtim, në literaturën nga fusha e andragogjisë penologjike është konstatuar se ekziston një ndarje tradicionale në mes të personelit të burgut dhe të dënuarve e cila plotësohet si një shprehje e përplasjes në mes të dy sistemeve të qëndrimeve, vlerave dhe normave. Në njërin anë janë "qëndrimet, vlerat dhe qëllimet e stafit, përfaqësuesve të sistemit formal me kërkesë për ri-edukim të të burgosurve. Nga ana tjetër është sistemi joformal me kodeskin e sjelljes së të dënuarit që tenton të largojë të burgosurit nga aktivitetet dhe kërkesat e personelit të burgut, në respektimin e mekanizmave të sistemit formal. Ky disharmonizim e reflekton dhe nganjëherë e thellon, si vetë organizimin dhe regjimin e institucionit,

ashtu edhe të dënuarit me pikëpamjet e tyre "(Macanović & Nadareviç 2014 fq.53-54).

Kushtet në INP, si dhe karakteri i vetë sanksionit që përfshin më tepër forma të kufizimeve, por edhe presion për t'u përmbajtur standardeve dhe normave të sjelljes, rregullisht krijojnë (të paktën nga ana e të burgosurve) rezistencë ndaj sistemit formal si dhe atyre që e përfaqësojnë atë (personeli i burgut). Në këtë aspekt, sistemi formal dhe ata që kanë mandat për t'a zbatuar atë, në sytë e të dënuarve janë përfaqësues të shoqërisë të cilët i kanë dënuar apo i kanë hedhur dhe i kanë vendosur në kushte inferiore të jetesës. Ky antagonizëm ndaj personelit të burgut në disa raste mund të rritet edhe në konflikt të hapur, dhe si bazë e ka sistemin e dënimit të vlerave, normave dhe kodin e sjelljes (Macanović & Nadareviç 2014).

Përmirësimi i atraktivitetit, cilësisë dhe efikasitetit të arsimit dhe trajnimit në INP mund të realizohet me rritjen e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të ndryshëm – ofruesve të arsimit, autoriteteve dhe menaxhuesve të INP-së, si edhe në mes të burgjeve dhe komuniteteve lokale, me qëllim që të sigurohet arsim dhe trajnim që e kanë filluar në INP dhe do të jetë në gjendje të vazhdojnë edhe pas lëshimit të tyre në liri.

Në procesin e planifikimit të programit arsimor / trajnimit në INP duhet të merren në konsiderim edhe faktorët e mëposhtëm:

- sa kohë nxënësit do të marrin pjesë në programin dhe gjatësinë e çdo orë;
- njohuritë dhe dobësitë arsimore të grupit;
- gjendja psikologjike e studentëve, spektri i vëmendjes, aftësitë ndërpersonale;
- Planet edukative dhe vokacionale të nxënësve pas lirit;
- resurset në dispozicion;
- madhësia e grupit dhe në pajtim me të, sa kohë do të ketë në dispozicion për punë individuale / të ndihmojë çdo nxënës (Twiss & Hodgson 2008 fq.27-28).

2.1.2. Faktorët ekzogen dhe resocializimi

Familja është një faktor i rëndësishëm në motivimin e të dënuarit që të marrë pjesë në edukim / trajnim. Zakonisht familja paraqet dhe lidhjen me botën dhe mjedisin ku për shkak të krimit të kryer i dënuari është izoluar. Në këtë kuptim, pasiguria e të dënuarit nga çrregullimet e marrëdhënieve familjare, materiale dhe probleme të tjera që i ka shkaktuar sanksionimi i tij, statusi familjar pas ngjarjes, mund të përdoren për korrigjim e pikëpamjeve dhe mendimeve të tij, si dhe motivimin që ta përmirësoj gjendjen e tij pas liritit nëpërmjet të arritjes së kompetencave të reja në procesin e shërbimit të dënimit (Macanović & Nadarević 2014 fq.105). Sipas sociologjisë së edukimit është vërtetuar një lidhje midis nivelit arsimor të prindërve dhe motivimit për arsim tek pasardhësit. Njerëzit prindërit e të cilëve kanë arsim do të kenë më pak motivim që të kyçen në procesin arsimor, sepse në këto raste shpesh arsimit gjendet në nivel të lartë në sistemin e vlerave të personit.

Faktorë të tjerë janë grupi në të cilin lëviz i dënuari dhe marrëdhënia e tij me stafin dhe menaxhuesit. Presioni i grupit, por edhe marrëdhëniet e këqija me stafin dhe menaxhuesit, mund të ndikojnë në zvogëlimin e motivimit për kyçje në arsim.

2.2. Dizajni dhe realizimi i programit arsimor në INP

2.2.1. Arsimit dhe resocializimi

Në procesin e zhvillimit të një programi arsimor / trajnues në INP nuk duhet të braktiset roli edukativ i arsimit, ose nevoja kjo komponentë të jetë në përputhje me programin e resocializimit të realizuar në INP. Arsimiti nuk duhet vetëm të stërvit të dënuarit të fitojnë aftësi dhe kompetenca të caktuara, por edhe të mbështes procesin e resocializimit, gjegjësisht të mbështesë procesin e marrjes së vlerave dhe normave që do të mundësojnë integrimin e tyre më të lehtë në shoqëri, por gjithashtu do të ketë një efekt parandalues që mos të bëjnë vepra penale në ardhmëri. Ky aspekt i arsimit shpesh neglizhohet, kryesisht për shkak të mungesës së interesimit për bashkëpunim në mes të palëve relevante. Megjithatë, neglizhenca e rolit edukativ të arsimit nuk e zvogëlon ndjeshëm efektivitetin e vetë procesit arsimor, por e humb mundësinë që përmes të qasjes holistike të punohet në risocializimin e të dënuarit.

Në këtë kontekst, në procesin e hartimit të programeve për arsim dhe resocializim të të dënuarve, duhet të merret parasysh edhe nevojat si dhe kufizimet

në drejtim të punës me të dënuarit të cilët mund të kenë ndikim të rëndësishëm në suksesin e procesit arsimor:

- Respektimi i dallimeve në mes të dënuarve dhe në përputhje me këtë edhe individualizimi i programit;
- Shumë të burgosur nuk mund të jenë të arsimuar dhe të ri-socializuar për shkak të çrregullimeve të personalitetit;
- Nuk janë të interesuar për përmirësim, nuk janë të motivuar për të jetuar pa krim, kështu që edukimi dhe ri-socializimi është e vështirë që të kryer me forcë dhe kundër vullnetit të tyre;
- Disave nuk ju duhet resocializim;
- Mjedisi jo i përshtatshëm nga të cilat të burgosurit vijnë dhe në të cilën do të kthehet pas shërbimit të dënimit;
- Organizimi i INP-së, i cili në disa raste të caktuara vepron në mënyrë shumë totalitare;
- Rrethanat shoqërore të izoluara. INP-ja ua merr të dënuarve shumë të drejta njerëzore si dhe rolet themelore sociale të cilët mund ti kryejnë përgjatë kohës së shërbimit të dënimit dhe me këtë nga të burgosurit më shumë merret se sa që jepet;
- Stafi profesional dhe trajnuesit nuk kanë aftësi të përshtatshme, gjë që rezulton në qasje dhe mënyra joadekuate të sjelljes, edukimit dhe risocializimit;
- Tek të kthyerit duhet që aftësitë për edukim dhe resocializim të përdoren përgjatë dënimit të parë, e jo më vonë, pasi që secilën herë tjetër mundësitë janë gjithnjë më të vogla (përshtatur nga Macanović & Nadareviç 2014 fq.103-104).

Qasja holistike e resocializimit, e cila e bashkon rolin arsimor dhe edukativ të arsimit dhe trajnimit, nënkupton bashkëpunim të ngushtë të shërbimeve profesionale të INP-së dhe organizatorëve të programit arsimor si dhe palëve relevante të kyçura në realizimin e tij. Ky bashkëpunim është i nevojshëm që të rezultojë në një program arsimor që pasqyron dhe mbështet strategji për resocializimin të implementuar në INP; menaxhuesit dhe shërbimet profesionale duhet të tregojë mbështetje për procesin e arsimit dhe të kontribuojnë në rjedhjen e suksesshme si dhe nxitjen e motivimit për mësim në mesin e grupit të synuar.

Ideja prapa procesit të resocializimit është që i dënuari "nga identifikimi negativ të kalojë të paktën rreth atij pozitiv, në lëvizjet kryesore të identifikohet me vlerat pozitive, me njerëz pozitiv, me mjedis pozitiv" (Macanović & Nadareviç 2014 fq.94-95). Megjithatë, i dënuari në burg përjeton një seri të përvojave negative dhe

kufizuese, kështu që identifikimi negativ vetëm thellohet. Burgu në përgjithësi është një mjedis i cili nuk inkurajon komunikim, por e kufizon atë. Ka një rrezik që procesi arsimor në INP të vendos të dënuarit në pozitën e objekteve të procesit arsimor, pa liri për të menduar kritik dhe iniciativë.

2.2.2. Periudha e shërbimit të dënimit në të cilën do të realizohet trajnimi

Zgjedhja e periudhës nga shërbimi i dënimit nga ana e vetë të burgosurit se kur do të kryhet trajnimi është i rëndësishëm dhe mund të ketë një ndikim të rëndësishëm mbi vetë efektin e trajnimit. Kjo është një faktor që mund të ndikojë si në efektet e drejtëpërdrejta, të menjëhershme dhe ashtu edhe në efektet afatgjate të trajnimit.

Trajnimi që kryhet pak para mbarimit të dënimit me burg, për shembull 1-2 vite para përfundimit të dënimit, mund të ketë një efekt më të drejtëpërdrejtë në integrimin e ish-të dënuar në shoqëri. Aftësitë janë pothuajse të mësuara dhe periudha e afërt e lëshimit nga burgu do të thotë që personi do të jetë më i aftësuar për zbatimin e tyre, gjë që e lehtëson riintegrimin. Megjithatë, nëse trajnimi është kryer shumë më herët nga mbarimi i dënimit, trajnimi do të ketë efekt vetëm nëse të dënuarit i jepet mundësi që ti përdor në praktikë aftësitë e mësuara në INP. Kjo është nënkusht që në INP-ja të ketë mundësi për kryerjen e detyrave punuese në të cilat mund të përdorin aftësitë e reja të mësuara nga ana e të dënuarit. Përndryshe, në qoftë se nuk ka kushte për ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive të fituara, nuk ka gjasa që i dënuari të jetë në gjendje t'i përdor dhe t'i aplikojë pas lëshimit në liri. Për shembull, trajnimi për fitimin e aftësive të **TIK-ut** nuk do të japë efektin e dëshiruar, nëse personit nuk i lejohet të aplikojë këto aftësi në praktikë deri në fund të dënimit të tij. Kjo vlen edhe për trajnimet për aftësi profesionale (hortikulturës, berberë, bukëpjekës, etj).

Në lidhje me këtë duhet të merret parasysh disa faktorë. Së pari, gjatësia e dënimit të të dënuarit. Gjatësia e dënimit është një faktor në zgjedhjen e kohës në të cilin i dënuari do të trajnohet, si dhe përzgjedhja e trajnimit, duke filluar nga kriteri i përfitimit të të dënuarit (nga cili trajnim i dënuari do të përfitojnë më tepër), por edhe preferencat individuale. Gjegjësisht, nga intervistat me trajnuesit në burgun në Shtip dhe Tetovë kanë treguar se rezultate më të mira kanë arritur ato pjesëmarrës të cilët vetë kanë bërë përzgjedhjen e trajnimit, ndërsa rezultate të dobëta (edhe anulimin dhe heqjen nga programi) kanë treguar pjesëmarrësit të cilët në trajnim u vendosën nga ana e administratës së burgut.

Faktori i dytë që është i rëndësishëm për periudhën e zbatimit të trajnimit është mundësia që trajnimet të vendosen në kuadër të detyrave punuese që mund

të kryhen në INP, dhe mundësia që i dënuari të përfshihet në kryerjen e këtyre detyrave. Nëse kushtet e lejojnë këtë (mundësia që të burgosurit të angazhohen në punë, llojin e dënimit, kushtet specifike dhe procedurat e sigurisë në SHNP), është e dëshirueshme që të dënuarve t'u lejohet të praktikojnë dhe rihvillojnë aftësitë e fituara përmes përfshirjes së tyre në operacionet në vetë INP-në (si ndihmës në kuzhinë, regullim hortikulturor në kopsht në SHNP, si berber). Mundësia që kjo punë të njihet si përvojë relevante e punës do të jetë një nxitje shtesë për angazhimin e tyre. Megjithatë, praktika në vend tregon se mundësia për angazhim në punë është jashtëzakonisht e kufizuar për personat që shërbejnë në burgje të mbyllura. Në këtë rast, pasiqë që të dënuarit pas trajnimit i pret shërbim i gjatë në burg, gjasat janë të vogla që ata do të jenë në gjendje që të aplikojnë njohuritë dhe aftësitë jashtë burgut, pa aplikimin e tyre në detyra konkrete punuese në INP.

2.2.3. Ndërlidhja e trajnimeve me kryerjen e detyrave punuese

Në arsimin konvencional kërkohet që studenti të adaptohet me kurikulën e vendosur; në arsimin për të rritur, rjedhimisht edhe në procesin arsimor në INP, kurrikula formohet në bazë të nevojave dhe interesave të pjesëmarrësve, por edhe faktorë të tjerë të ndërlidhur me kufizimet (financiare, organizative, të sigurisë) në vetë INP-në. Është e qartë se mundësia për punë praktike në INP, e cila do të jetë e lidhur me aftësitë e reja të fituara mund të jetë një faktor shumë i rëndësishëm në zgjedhjen e trajnimit për të dënuarin. Momenti kyç është ai se cilat lloje të punëve, janë të mundshme në INP, si edhe cilat nga ato janë mundësi për konkret ndonjë të dënuar, në varësi nga vetë rregullat të cilat vlejnë në INP.

Ky është një faktor që duhet të merret plotësisht parasysh në procesin e planifikimit të punës arsimore me të rritur në burg. Kjo do të thotë në vijim: së pari, ne kemi nevojë për një njohuri të mirë të rregullave që vlejnë në INP, të cilat janë për përfshirjen e të dënuarve në detyrat e punës; së dyti, është e nevojshme përfshirja e stafit relevant të INP-së në procesin e vlerësimit të nevojave dhe përzgjedhjen e trajnimit; së treti, është e nevojshme për të marrë parasysh përvojën e mëparshme (punë, arsim) të të dënuarve, dhe interesat e tyre në lidhje me fitimin e njohurive dhe aftësive të caktuara.

Në përputhje me dokumentet ndërkombëtare, në procesin e përzgjedhjes së programeve të caktuara arsimore dhe trajnimit, përparësi duhet t'u jepet të dënuarve të cilët nuk kanë pasur asnjë lloj arsimit ose nuk kanë përfunduar arsimin fillor, dmth. ata të burgosur që kanë nevojë për programe të shkrimit dhe leximit. Përveç kësaj, përgjatë krijimit të këtyre programeve, përveç faktorëve të përmendur më parë për punë në burg, është e nevojshme që programet të jenë në përputhshmëri me kërkesat e insitucioneve kompetente në domenin e arsimit,

gjegjësisht të bëhen përpjekje që programet të akreditohen, meqëllim që pjesëmarrësve do të mund të ju vlerësohet përfundimi i suksesshëm i programit. Trajnimi për aftësi themelore për shumë të burgosur është hapi i parë drejt plotësimin të nevojave themelore. Megjithatë, përvoja tregon se këto nevoja shkojnë përtej aftësive themelore të shkrim-leximit, matematikës dhe gjuhëve, dhe përfshijnë fusha të tilla si aftësitë themelore të kujdesit shëndetësor, zhvillimit personal, të cilat mund të lehtësojnë riintegrimin e tyre (Hawley et al., 2013 f.25).

Në procesin e përzgjedhjes së programeve për arsim / trajnim, është e nevojshme që të merren parasysh mundësitë e ofruara në INP-të tjera (programet arsimore, programe për trajnim profesional) me qëllim që arsimit të dënuarit të mos ndërpritet në rast të zhvendosjes nga një SHNP në tjetër. Gjithashtu është e nevojshme që të analizohen dhe mundësitë për vazhdimin e arsimit / trajnimit edhe jashtë burgut, në rast kur i dënuari lëshohet në liri.

2.2.3.1. Praktika punuese jashtë INP-së

Mundësia për të punuar jashtë INP-së, atëherë kur është e lejuar, mund të jetë veçanërisht e rëndësishme për efektet e arsimit. Të burgosurit, në varësi nga trajtimi në të cilën gjenden, dhe me leje nga INP-ja dhe DZS, mund të punojnë jashtë burgut. Mundësia për punë varet nga interesi i firmave që do të kishin nga punësimi i të dënuarit. Është e nevojshme që një kompani e caktuar të ketë interes që ta punësojë të dënuarin. Shpesh, efekti arsimor nga angazhimi i punës nuk është pjesë e rëndësishme e marrëveshjes. Në procesin e planifikimit të arsimit dhe trajnimit në INP duhet të hulumtohet mundësia e një qasje më sistematike për sigurimin e praktikave të punës gjegjësisht angazhimeve punuese të cilët të dënuarve do të ju mundësojë përvetsim, ose shpërblim të aftësive punuese, duke i përfshirë këtu edhe ata të cilët i kanë fituar përmes trajnimit në burg.

2.2.3.2. Ndihma përgjatë kërkimit të punës menjëherë pas daljes nga INP-ja

Integrimi i shpejtë i të dënuarit në mjedisin e punës menjëherë pas çlirimit, me ndihmën e aftësive punuese të fituara përgjatë trajnimit në INP është i rëndësishëm për procesin e resocializimit. Është e dobishme që të hulumtohen mundësitë e lidhjes së trajnimeve me ndihmë, që të dënuarit të fillojnë shpejtë në punë menjëherë pas shërbimit të dënimit. Me rëndësi kyçe mund të jetë edhe bashkëpunimi i mirë në mes shërbimeve sociale dhe palëve të tjera relevante, për të siguruar mbështetje për të dënuarin në procesin e riintegrit në mes.

2.2.4. Koha e nevojshme për planifikim dhe zbatim

Kushtet specifike në INP e imponojnë nevojën për shpërndarjen e kohës përgjatë planifikimit të procesit arsimor, sidomos kur është fjala për futjen e një proces të ri (përmes projektit) në INP. Gjithashtu, është e nevojshme të sigurojnë kohë të mjaftueshme për procesin e arsimimit ose trajnimit. Afatet e shkurtra nuk janë në dobi të efektivitetit të procesit arsimor.

Gjithashtu, urgjenca ose kohëzgjatja e shkurtër e aktivitetet kryesore (p.sh. i gjithë trajnimi duhet të përfundoj për 2-3 muaj) nuk janë në dobi të rezultateve të mira. Është e nevojshme për proceset të sigurohet kohë e konsiderueshme e cila do të mundësojë të bëhen adaptimet e duhura. Kjo mund të jetë një problem te projektet e financuara nga donatorët, të cilët e përcaktojnë kohëzgjatjen në afat kohor relativisht të shkurtër (p.sh.. maksimum për 1 vit), dhe afate strikte dhe të pandryshueshme. Këta afate kohore nuk janë optimale për procesin arsimor në INP.

Përveç kësaj, në organizimin e arsimit dhe trajnimit në INP duhet të shihet si një proces afatgjatë. Në këtë drejtim, edhe kur flitet për programe të cilët kryhen si pjesë e projektit, duhet të mendohet për zgjidhje alternative të cilët mund të mbështesin procesin arsimor edhe pas përfundimit të projektit. Për shembull, organizimi i arsimit dhe trajnimeve për stafin e burgut, me qëllim që aktiviteti arsimor të vazhdohet nga ana e vetë të punësuarve (nëse ekzistojnë kushte të përshtatshme, kjo nuk është e realizueshme në INP-të të cilët ballafaqohen me numër të pamjaftueshëm të stafit, siç është rasti me shumë burgje në Maqedoni).

Planifikimi afatgjatë i procesit arsimor në INP nënkupton se duhet të ketë qasje të laramanishme në drejtim të gjatësisë së programit për arsim dhe trajnim në institucionet e llojeve të ndryshme. Gjegjësisht, në institucionet ku ndodhen personat që shërbejnë dënime më të shkurtra (nga disa muaj deri në tre vjet) është i nevojshëm adaptimi i programit me gjatësinë e dënimit të të burgosurit. Trajnimi për disa muaj në këtë rast mund të jetë një përfitim i madh (sidomos nëse kemi pasur parasysh se këto grupe të të burgosurve – me dënime më të shkurtra janë shpesh të përjashtuar nga procesi mësimor), veçanërisht në qoftë se ka mundësi për vazhdim të arsimit edhe pas lëshimit në liri. Në rastet kur të dënuarit shërbejnë një dënim të gjatë me burg, efektiviteti do të jetë më i madh nëse arsimi është një proces i gjatë.

2.2.5. Nevojat dhe interesat e të dënuarve

Që të jetë edukimi efektiv në INP, programet për arsim dhe trajnim nuk duhet të jenë të dizajnuara pa u marrë në konsiderim njohuritë ekzistuese dhe aftësitë, si dhe interesat e të burgosurve. Gjithashtu duhet të merret parasysh edhe riziku, i pranishëm në kontekstin e arsimit i cili ka për qëllim për të ndryshuar ose korigjuar sjelljen, që e njëjta mund të perceptohet nga ana e nxënësve si një gjë e imponuar nga sistemi i jashtëm si një detyrim (sistemi formal në INP) (Kombet e Bashkuara dhe UNESCO Instituti për Arsim, 1995, fq. 23). Prandaj është e rëndësishme që të sigurohet interesi dhe motivimi i grupit, me anë të marrjes në konsideratë të nevojave dhe kufizimeve të tyre.

Qasja edukative që promovon standardizim thjesht tregohet si jofunksionale në kontekstin e nevojave arsimore në INP. Është nevojshme që nevojat e nxënësve të vendosen në qendër të procesit arsimor. Në këtë drejtim, qasja e individualizuar që i reflekton nevojat e ndryshme të popullsisë në burg është një parakusht për zhvillimin e suksesshëm të aftësive, njohurive dhe cilësive personale të nevojshme për jetën në burg dhe pas burgut. Ofrimi i "më shumë se të njëjtës në kuptim të kurrikulës jofleksibile, të intonuar akademikisht, shkollor të bazuar nuk do të jep një rezultat të mirë" (Braggins & Talbot, 2003, fq.7).

Për pjesën më të madhe të burgosurve, fillimet e sjelljes së tyre devijante janë të ndërlidhura me moshën shkollore, me arsimin fillor ose të mesëm. Shumica e tyre kanë shkuar në shkollë dhe kanë përfunduar një fazë të procesit arsimor (të paktën disa njësi). Në burg nuk duhet të fillojnë menjëherë nga fillimi arsimimin e tyre për shkak se ajo ndikon në mënyrë demotivuese për të burgosurit, por duhet të vazhdojnë aty ku janë ndalur ose të parakualifikohen për profesione që ju interesojnë. Kjo lejon që programi të zgjas më shkurtër, që do të thotë efikasitet më të madh, me më shumë gjasa që një pjesë e konsiderueshme e grupit do të përfundoj me sukses programin, dhe me këtë vetë të dënuarit janë më të motivuar që të marrin pjesë në to.

Në shërbimin e burgjeve ka edhe të dënuar me kualifikim të lartë (edhe pse në përgjithësi, kjo përqindje është e ulët). Këta njerëz nuk duhet të përjashtohen nga mundësia që ti zhvillojnë aftësitë e tyre (në qoftë se ka mundësi për të organizuar programe për njohuri / aftësi të përparuara). Nëse nuk ka mundësi të tilla, ata mund të kontribuojnë në realizimin e suksesshëm të procesit arsimor në institucionin të angazhuar si ndihmës të trajnuesve - mentorë të dënuarve të tjerë. Në këtë mënyrë ata nuk janë të përjashtuar nga procesi arsimor, dhe kjo praktikë kontribuon në forcimin e bashkëpunimit mes trajnuesit dhe të burgosurve, por edhe në mesin e të dënuarve.

2.2.6. Dizajni i përshtatshëm i procesit arsimor

Është e dëshirueshme që procesi arsimor me të rritur në INP të ketë dizajn më të adaptueshëm. Kjo përfshin më shumë aspekte të procesit arsimor, si për shembull, strukturën e trajnimit (strukturën e tërë trajnimit, strukturën e orës, kohëzgjatja e orës, njësitë tematike në orë, etj). dinamikën e trajnimit (orarin e orëve, numri i orëve në javë, etj). trajnuesit dhe vetë programin (kurrikula). Këto parime kanë aplikim të gjerë përtej temës së arsimit të të rriturve në INP, dhe natyrisht, edhe vetë tema është mjaft e gjerë. Për qëllimet e këtij doracaku janë të mjaftueshme vetëm disa ilustrime që do të shpjegojnë më tej qëllimin e këtyre rekomandimeve.

Shumë procese arsimore kanë një strukturë fikse. Saktësisht dihet kohëzgjatja e tërë procesit (p.sh. një vit). Saktësisht dihet termini e një ore të vetme, dhe ai nuk është i adaptueshëm për nevojat e studentëve. Ndonjëherë mund të jetë i adaptueshëm për mësuesin, për shembull, kur mësuesi është vonë, që është (nganjëherë) e toleruar apo e "lejuar". Saktësisht dihet dinamika e programit (ka tekst standard). Dinamika është fikse, dhe nganjëherë mund të jetë e përshtatur për nevojat e mësuesit, por zakonisht jo nxënësit. Mësuesi e definojnë natyrën e komunikimit, nivelin dhe llojin e pjesëmarrjes, diskutimin etj. Ajo është veçanërisht e dukshme në aspektin e nxënësve të cilët mund të përshkruajnë dallimet më të detajuara ndërmjet mësuesve të ndryshëm. Personaliteti i mësuesit dhe sjellja e tij kanë një ndikim të madh në këtë proces. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në arsimin formal. Shumë nga këto momente janë gjithashtu të rëndësishme edhe për format e ndryshme të arsimit jo-formal dhe arsimit për të rritur.

Sigurisht që adaptimi i tërësishëm i procesit arsimor nuk është i mundur, sepse kjo do të thotë mungesa e çdo strukture. Megjithatë, ngurtësia e procesit nuk është e rekomanduar për punën edukative me të rriturit në INP. Nuk është e dëshirueshme që mësuesi të këmbëngul për "rrugën e tij /të saj për të bërë gjërat." Pastaj mund të ndodhë që pjesë të programit arsimor nuk janë të përshtatshëm për një pjesë të pjesëmarrësve. Duhet të merret parasysh se shkalla e arsimit të përgjithshëm në mesin e të burgosurve në INP, është në nivel përgjithësisht të ulët, dhe kjo ndikon në programin arsimor.

Fleksibiliteti në drejtim të zbatimit të programit do të thotë përshtatje në mësimdhënie / trajnim – për shembull, gjatësi fleksibile dhe strukturë fleksibile të orëve. Ngurtësia në këtë drejtim mund të ulë motivimin për të marrë pjesë nga ana e atyre të dënuarve të cilët për arsye të ndryshme ballafaqohen me vështirësi në mësim.

Problemi i verifikimit të programeve arsimor në INP mund të jetë një sfidë sa i përket nevojave për fleksibilitet të imponuar nga kushtet specifike (kufizime të

imponuara nga mjedisi, nevoja dhe kufizimet e grupit të synuar). Në këtë aspekt, në hartimin e programit arsimor duhet të përpiqet që të sigurohet që qëllimet dhe rezultatet e programit të korrespondojnë me proporcionet për verifikimin, ose për të mundësuar pjesëmarrësve që pas përfundimit me sukses të programit të pajisen me njohuri dhe shkathtësi sipas kritereve zyrtare. Fleksibiliteti u referohet metodave dhe mjeteve për realizimin e programit (numrin e orëve, frekuencën, metodat dhe mjetet), por kompetencat që duhet të fitojnë pjesëmarrësit duhet të jenë në përputhje me kriteret për verifikimin e programit ..

2.2.7. Pëkushtim afatgjatë

Rezultatet më të mira do të arrihen poqese puna arsimore në INP është në kontinuitet, dmth kur ka një përkushtim në afat të gjatë nga ofruesi i shërbimeve arsimore. Kjo nuk do të thotë se personi i dënuar duhet në kontinuitet të jetë i kyçur në procesin e të mësuarit. Kjo nuk është realiste. Por, kontinuiteti mund të krijojë mundësi për praktimin e asaj që njëherë e ka mësuar, për të plotësuar apo përmirësuar njohurit, etj. Vijimi i rregullt do të krijojë një shprehi, do të ofrojë një spektër të gjerë të mundësive për kyçje, dhe për kthyerje të arsimit në diçka të rregullt, çdo ditshme, në vend se diçka e rastit ose aty për aty.

Angazhimi afatgjatë nënkupton sigurimin e kushteve për vazhdim të arsimit / trajnimit pas shërbimit të dënimit, si dhe ekzistimit të një sistemi të mbështetjes përgjatë procesit të riintegritimit në komunitet.

2.2.8. Përgatitja e personelit relevant në INP

Në rast kur puna edukative në INP është bërë në bazë të projektit dhe projekti kryhet nga një organizatë e jashtme, nevojitet një proces të përgatitjes së personelin përkatës të INP-së. Ajo me siguri duhet ti përfshijë menaxhuesit dhe trajnuesit të cilët do të jenë të prekur nga, ose në ndonjë mënyrë të kyçur në projekt. Ka disa arsye për këtë. Së pari, projektit i nevojitet mbështetje e plotë e personelit në INP. Pa këtë mbështetje projekti nuk mund të arrijë rezultate optimale, dhe madje mund të përballet me rreziqe serioze në zbatim.

Së dyti, ajo që është veçanërisht e rëndësishme, është që stafi menaxhues të përshtatet me proceset që do ti kyç projektin. INP-ja është tip i mbyllët i institucioneve dhe puna në to është objekt i shumë rregullave. Në afate të gjata, ajo krijon praktika me bazë dhe mënyra të sjelljes. Kyçja e proceseve të reja, për shembull, duke filluar me ndonjë projekt, do të thotë një ndryshim nga e zakonshmeja, dhe kërkon

përshtatje për këtë ndryshim. Për këtë duhet kohë, dhe sigurisht që nevojitet njohtim me projektin, ndarje të detajeve për punën që duhet të zbatohet, etj. Qasja më efektive do të jetë përfshirja e personelit përkatës të INP-së në fazën më të hershme të vlerësimit të nevojave dhe planifikimit. Kjo nuk mund të jetë e mundur në çdo rast, duke pasur parasysh rrethanat e ndryshme në të cilat mund të bëhet planifikimi i hershëm i projektit (p.sh.. Në një situatë kur korniza financiare ende nuk është e siguruar). Megjithatë, sigurisht që rekomandimi është përfshirja e hershme e stafit përkatës në proces

2.3. Motivimi i pjesëmarrësve

Është mirë që edukimi në INP të ketë zhvilluar një strategji për motivimin e të dënuarve. Është logjike që të pritët më shumë punë për motivimin në këtë lloj të arsimit për të rritur, sidomos nëse merret parasysh rezistenca që mund të ekzistojë midis disa të dënuarve, që arsimin e perceptojnë si pjesë e "rregullave të imponuara" të sistemit formal. Është e nevojshme që strategjia për motivim të zhvillohet në bazë të vlerësimit të mirë të rrethanave.

Motivimi i personave që shërbejnë dënim me burg mund të jetë më i madh me përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies, që vendosin në theksim nxënësin dhe mbështeten në njohuritë e tij të mëparshme si dhe përvojën. Në raste të caktuara (në qoftë se nuk është në konflikt me politikat penale) kjo mund të përfshijë edhe përdorimin e TIK dhe të mësuarit në distancë, që jo vetëm që i zgjeron mundësitë e të mësuarit, por gjithashtu mund të sigurojë që të mësuarit mund të vazhdojë edhe në qoftë se i dënuari është transferuar në një institucion tjetër ndëshkues-përmirësues.

Elementet e motivimit mund të jenë të ndryshme. Çertifikat / diploma e trajnimit është padyshim një motivim i fortë. Ajo merr forcë kur çertifikata është verifikuar nga sistemi arsimor, në qoftë se kushtet konkrete e lejojnë atë. Mundësia për punë praktike jashtë INP-së, në rrethana ku ajo është reale, mund të jetë një motivim i fortë. Interaktiviteti i trajnimit, stimulime të vogla të inkorporuara (p.sh.. shpërblime, gara, etj.) mund të jenë elemente të motivimit. Duhet të merret parasysh mundësia për punë individuale me përdoruesit e trajnimit në formën e mentorimit apo mbështetja të vazhdojnë në trajnim.

Shumë nga të dënuarit kanë përjetuar ndonjë lloj traume. Trauma manifestohet në strategjitë / aftësitë përbaluese të dënuarit të zhvilluara për të mbijetuar në rethinë. Këto strategji përbaluese mund të jenë shumë të dobishme, por gjithashtu mund të ndikojë negativisht në motivimin dhe suksesin në arsim. Simptomët e traumës zakonisht paraqiten përmes manifestimeve të mëposhtme:

- Mungesa;
- Introveritet i pazakontë;
- Mungesa e energjisë; vëmendjes ose koncentrim i ulët;
- Zhvillimi i mendimeve negative në lidhje me veten e tyre dhe botën;
- Ndryshime në oreks, peshë ose gjum;
- Ndjenjë e pavlefshmërisë, pafuqisë apo shpresës (Twiss & Hodgson 2008 fq.20).

Në këtë aspekt, është i rëndësishëm bashkëpunimi me autoritetet kompetente dhe ekspertë në institucion, me qëllim që ti ndihmohet të dënuarit që më lehtë ta tejkaloj problemin dhe të vazhdoj procesin e resocializimit dhe edukimit.

2.4. Roli i trajnuesit

Trajnuesi është faktori kyç që mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në suksesin e programit arsimor. Trajnuesi është personi i cili e përfaqëson, zbaton programin dhe në mënyrë më direkte është i ekspozuar ndaj kufizimeve dhe sfidave në zbatimin e mësimdhënies / trajnimit në mjedisin e burgut. Në këtë drejtim, kemi nevojë për trajnerë që kanë arsimin përkatës dhe përvojë për arsimin e të rriturve por edhe të kenë njohuri për andragogjinë penologjike. Duke marrë parasysh përfaqësimin e dobët të andragogjisë penologjike si pjesë e trajnimit arsimor të edukatorëve në vendin tonë, thelbësisht duhet trajnim paraprak të personave të cilët do të jenë të përfshirë në kryerjen e programit edukativ.

Një aspekt tjetër i përgatitjes është aspekti psikologjik. Tek disa trajnues është e mundshme të kenë stres apo ankth për shkak të kushteve specifike në të cilat realizohet trajnimi. Kjo kërkon komunikim me stafin menaxhues të burgut i cili do t'i orientojë trajnerët, do t'u përgjigjet pyetjeve të tyre dhe do t'u ndihmojë atyre që të përshtaten në rethinë. Përveç kësaj, përvoja relevante e trajnuesve nuk është gjithmonë një garancë se ata janë të përfshirë në procesin arsimor, pa paragjykime për grupin e synuar. Për shembull, disa trajnerë qasen me pikpamje të paraformuluar mbi të burgosurit, si për njerëzit me inteligjencë deficitare. Prandaj, përgjatë procesit të përgatitjes një vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet edhe

këtij segmenti, në mënyrë që të lejojë zhvillimim e marrëdhënieve produktive me nxënësit.

Një aspekt tjetër i përgatitjes ka të bëjë me kushtet specifike hapësinore dhe kushtet materiale në të cilët do të kryhen trajnimet. Kushtet në burg shpesh do të jenë më keq se zakonisht. Trajnuesit duhet të orientohen dhe të përshtaten me kushtet e veçanta para fillimit të procesit arsimor. Trajnuesi duhet të jetë tërësisht i njohur me rregullat e sjelljes dhe komunikimit në institucion, në mënyrë që t'a përshtat sjelljen e tij me punën e sistemit ekzistues.

Aktiviteti arsimor dhe resocializues në INP bazohet në disa parime themelore që duhet të jenë të integruara në punën e trajnuesit:

- Parimi i njohjes së personalitetit të të dënuarit;
- Parimi i integritetit të të dënuarit;
- Parimi i besimit dhe respektit për dinjitetin e të dënuarit;
- Parimi i pjesëmarrjes së vetëdijshme dhe aktive të të dënuarit në procesin arsimor;
- Parimi i individualizimit;
- Parimi i shkathtësive të gjithanshme të arsimit / risocializimit;
- Parimi i unitetit të ndikimit arsimor dhe edukativ (përshtatur nga Macanović & Nadareviç 2014 fq.176-177).

Nënkapitujt që vijojnë ofrojnë udhëzime dhe strategji arsimore që duhet të merren parasysh në orientimin e punës së trajnuesit.

2.4.1. Tejkalmimi i kufizimeve të punës në INP

Siç është shpjeguar deri tani, zbatimi i edukimit / trajnimit në INP imponon kufizime që mund të kenë një ndikim negativ në efikasitetin e procesit arsimor. Në

lidhje me këtë në vendin tonë nuk ka hulumtime relevante që mund në mënyrë më precize të tregojnë sfidat konkrete me të cilat përballen vetë trajnuesit. Si pjesë e një studimi të kryer në mesin e trajnuesve në burgje në Mbretërinë e Bashkuar, si sfida kryesore në punë kanë qenë identifikuar sfidat në vijim:

- Problemi kryesor ka qenë vëllimi i madh i punës që del nga nevoja për të marrë një qasje të individualizuar për çdo nxënës;
-
- Jobashkëpunimi dhe maltretimi nga ana menaxhmentit, si dhe shkalla e lartë e lëvizjes së të dënuarve ishin të konsideruara si sfida të rëndësishme për realizimin e duhur të punës;
- Praktika manipulative nga ana e të burgosurve, dhuna fizike apo lloj tjetër i maltretimit në shumicën e rasteve janë shënuar si një problem / sfidë në punë;
- Një pjesë e rëndësishme e pjesëmarrësve në studim (edukatorët) ka thënë se procedurat e sigurisë në burgje kanë një ndikim negativ në procesin e arsimit (p.sh. pamundësia për të përgatitur materiale mësimore online, ligjërata për **TIK** pa përdorur aspektet kryesore të teknologjisë moderne, internet) (Rogers dhe bashkëpunëtorët., 2014 fq.23-24).

Këto probleme tregojnë për një spektër të gjerë të aspekteve në punën e trajnuesit. Nevoja për një qasje të individualizuar në punë mund nuk paraqet një risi në fushën e arsimit për të rritur, por duhet të theksohet se INP-ja paraqet një mjedis në të cilin këto dallime janë shprehur në mënyrë dramatike. Trajnuesi duhet të jetë i vetëdijshëm për këto sfida dhe të qaset me një strategji të para-caktuar për të punuar me nxënësit, si për shembull punë në grupe të vogla, grupimi i pjesëmarrësve sipas nivelit të njohurive të mëparshme dhe të tilla. Vendosja e marrëdhënieve të mira dhe bashkëpunimit me stafin në INP duhet të jetë e realizuar para fillimit të aktivitetit arsimor. Koordinimi i duhur, bashkëpunimi dhe mbështetja në mes të trajnuesit dhe personelit të burgut mund të ketë rëndësi të madhe për motivimin e të burgosurve. Në këtë kontekst, drejtori dhe menaxhmenti i burgut gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e arsimit në INP dhe formimin e një mjedisi pozitiv arsimor. Përgatitja e duhur paraprake për punë në rrethana të rrezikshme dhe strategjitë e duhura për të minimizuar konfliktet e mundshme duhet të jenë të zhvilluara dhe miratuara nga trajnuesi para kryerjes së veprimtarisë arsimore. Trajnuesi duhet të jetë i njohur mirë edhe me rregullat dhe procedurat e sigurisë që parandalojnë përdorimin e mjeteve të caktuara arsimore apo metodave në përgatitjen e aktiviteteve arsimore me qëllim që të jetë në gjendje ta kompensoj mungesën e tyre, pa pasur ndonjë ndikim negativ në procesin arsimor.

Duke pasur parasysh se arsimi në INP zhvillohet në një kontekst specifik, respektivisht se pjesëmarrësit në proces nuk janë në një mjedis që ata e konsiderojnë të përshtatshëm, sfida që të krijohet një atmosferë për mësim është e rëndë. Prandaj procesi i punës me të burgosurit duhet ti përfshijë komponentat e mëposhtëm:

- Qasje humanistike në arsim / trajnim, ku të dënuarit shihen si subjekte të afta për të shprehur nevojat dhe përvojat, jo si objekte;
- Qasja humaniste nënkupton angazhim të trajnuesit në drejtim të: zhvillim të marrëdhënieve midis trajnuesit dhe të dënuarit;
- T'u ndihmohet të burgosurve në zhvillimin e vetë-respektit, aftësive dhe mundësive për mendim reflektues të jetës së tyre;
- Ndryshim i perceptimit publik për arsimin jo-formal për të burgosurit, duke përfshirë edhe personelin e burgut;
- Përshtatje për nevojat dhe preferencat e të dënuarve
- Qasje holistike për arsimin dhe trajnimin vokacional për të dënuarit. Sepse burgu "vret", iniciativën, dhe aftësitë sociale që duhet të zhvillohet paralelisht me aftësitë bazike.

2.4.2. Strategjitë arsimore për punë në institucionet ndëshkuese-përmisuese

Në procesin e krijimit të komunikimit dhe bashkëpunimit me grupin e nxënësve, trajnuesi do të duhet të përshtat sjelljen e tij në pozitëm e veçantë në të cilën ndodhet grupi. Është e nevojshme të jetë i vetëdijshëm për motivimet dhe interesat e tyre t'i qasen mësimin, por në të njëjtën kohë gjithashtu duhet të vendos rregullat për komunikimin dhe respektin reciprok (përshtatur nga Twiss & Hodgson 2008):

- të burgosurit kanë pak mundësi për kontakt me botën e jashtme, dhe kanë nevojë të theksuar për formimin e lidhjeve me njerëz të tjerët. Për shumë prej tyre njoftimi i një person të ri mund të jetë një nxitje për pjesëmarrje në arsim / trajnim;
- Trajnuesi duhet të jetë i kujdesshëm në lidhje me të dhënat personale të cilat ndahen me nxënësit;
- Një rregull e mirë në lidhje me shkëmbimin e informatave personale është të kemi një qëllim të ndarjes. Dhënia e detajeve të panevojshme nga e kaluara e trajnuesit apo ekspozimi i dobësive të tij para grupit është joproductive;

- Gjithmonë duhet të respektohen kufijtë dhe privatësia e nxënësve - disa prej tyre janë të gatshëm për të ndarë të dhënat personale dhe tregime, sidomos temat që ata janë të ndjeshëm (p.sh. familja, veprën që e kanë kryer). Ka shumë gjasa që trajnuesi do të lidhet me nxënësit poqese i respekton kufijtë e tyre, poqese i vendos të vetat.

Në punën edukative me të dënuarit, trajnuesi udhëhiqet kryesisht nga parimet dhe metodat nga arsimimi i të rriturve. Edhe pse pjesa më e madhe e popullsisë së burgosur kanë arsim të ulët, pak arsim ose nuk kanë përfunduar asnjë lloj arsimi, kjo nuk do të thotë se motivet, interesat dhe mënyra e punës ndryshojnë nga ajo e nxënësve të tjerë të rritur. Sipas kësaj, trajnuesi duhet të marrë parasysh karakteristikat e këtij grupi të nxënësve (përshtatur nga Knowles S., Holton F., & Swanson A. 2005; Kamp 2011):

1. Nxënësit e rritur kanë nevojë të jenë të lirë që vetë të orijentohen në procesin arsimor, të vendosin për veten e tyre dhe për atë që ata duan të mësojnë, sa kohë mund të mësojnë në cilin drejtim do të vijoj procesi arsimor. Nxënësve të rritur duhet t'u mundësohet që vetë të vendosin qëllimet e të mësuarit. Në këtë kontekst, arsimi do të jetë më efektive nëse procesi është iniciuar nga vetë të dënuarit dhe atyre u është lejuar të përparojnë me tempon e vet. Përveç kësaj, trajnuesi i arsimimit të të rriturve duhet të përpiqet që në mënyrë aktive të përfshijë pjesëmarrësit në trajnim. Për shembull, para ose në fillim të trajnimit pjesëmarrësit duhet të informohen në lidhje me atë që do të mësojnë, të shpjegohet me gjuhën dhe fjalorin që është e kuptueshme dhe e pranueshme për ta. Roli i trajnuesit është që të jetë nxitës që i çon pjesëmarrësit drejt dijes në vend se vetëm ti furnizoj ata me fakte.
2. Të rriturit kanë grumbulluar një bazë të përvojave të jetës dhe njohurive. Në krahasim me nxënësit e vegjël, nxënësit e rritur kanë një diapazon shumë më të gjerë të përvojave jetësore dhe njohuri të fituara më parë, të cilat mund të rrjedhin nga arsimi paraprak formal ose joformal, aftësi dhe përvoja të fituara nëpërmjet procesit të punës, si edhe nga rolet sociale që individit i ka në faza të ndryshme të jetës. Përvojat e kaluara mund të kenë një ndikim të thellë, jo vetëm në aspektin e qëndrimeve të nxënësve ndaj trajnimit dhe temës, por edhe në rezultatin e procesit të të mësuarit. Gjegjësisht, në qoftë se përvoja e re nuk korrespondon me atë që të rriturit tashmë e din, ata mund të japin rezistencë për të mësuar. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të bëhet një lidhje reciproke në mes të përvojës aktuale arsimore dhe përvojave të kaluara të nxënësve, në mënyrë që kjo lidhje të bëhet më e dukshme për grupin. Duke pasur parasysh këtë, është mirë që trajnimi të filloj me zbulimin se çfarë është ajo që pjesëmarrësit tashmë e din në lidhje me temën dhe t'u jepet mundësia që ata vetë të ndajnë dhe diskutojnë këto përvoja / njohuri;
3. Nxënësit e rritur më lehtë do të fillojnë procesin e edukimit në qoftë se ekziston një lidhje në mes të edukimit / trajnimit dhe qëllimeve të tyre të

përcaktuara në mënyrë individuale. Të mësuarit do të jetë më efektiv nëse trajnimi në mënyrë të plastifikuar tregon se si kontribuon për realizimin e qëllimeve të tyre (fitimin e aftësive të punës, leximit). Prandaj, është me rëndësi që trajnuesi t'i paraqes benefitet nga vetë trajnimi. Ata duhet që në mënyrë eksplicite të shënohen nga ana e trajnuesit në fillim të mësimdhënies / trajnimit;

4. Nxënësit e rritur kanë nevojë për të parë në mënyrë të qartë arsyen se pse duhet të mësojnë diçka. Kështu, ata duhet të binden për rëndësinë e të mësuarit: mësimi duhet të jetë i zbatueshëm për punën e tyre apo rolet e tjera të lartëvlerësuar, si ndihmë për familjen apo komunitetin. Për më tepër, është e mirë që të bëhet lidhja në mes përmbajtjes dhe temave të trajnimit me shembuj që janë të njohura për nxënësit. Përmbajtja e trajnimit duhet të jetë i paraqitur si një problem i zbatueshëm në jetën reale dhe në kontekst të afërt për nxënësit;
5. Nxënësit e rritur kanë një qasje praktike për të mësuarit dhe ata mësojnë më mirë poqese janë aktiv, jo në një proces pasiv. Në këtë kontekst, elementi i veprimtarisë duhet të ketë një vend qendror në trajnim / arsim. Përdorimi i ushtrimeve praktike në të cilën dituria gjenerohet në mënyrë interaktive apo ku njohuritë e fituara rishtas mund të testohen ose të merren nga vetë nxënësit (duke i dhënë një mundësi për të vetë-prodhuar diçka, për shembull);
6. Të rriturit, si të gjithë nxënësit, duhet të respektohen si individë. Në këtë drejtim, trajnuesi duhet përgëzuar për pjekurinë e tyre dhe një pasuri të njohurive dhe përvojës. Nxënësit duhet të trajtohen si të barabartë në njohuri dhe përvojë dhe të lejohen të shprehin lirshëm mendimin e tyre. Respekti i ndërsjellë dhe besimi si dhe një frymë e bashkëpunimit duhet t'a karakterizojnë ambientin edukativ.

Tabela 1. Bartja e teorisë në praksë (e adaptuar nga Kamp 2011, fq.16).

| Bartja e teorisë në praksë | | |
|--|---|--|
| Teorija | | Praksa |
| Të rriturit mbajnë mend vetëm 10 % nga ajo që e kanë dëgjuar, 65% e asaj që e shohin dhe dëgjojnë 80% të asaj që ata shohin, dëgjojnë dhe bëjnë. | ➔ | Që të zmadhohet retencioni, duhet të sigurohet stimulimin auditiv dhe vizual si dhe kyçje të ushtrimeve. |
| Të rriturit e përfshijnë një pjesë të madhe të përvojës së tyre jetësore dhe njohurive në procesin e të nxënësve | ➔ | Ndërlidhja e përvojave jetësore dhe informatave të reja. Përdorimi i përvojave nëpërmes të inicimit të diskutimeve. |
| Të rriturit janë autonom dhe të vetë-drejtuar. | ➔ | Kyçja e nxënësve në procesin e mësimit; trajneri duhet të jetë edukator, në vend të vetëm transmetimit të informatave. |
| Të rriturit mësojnë më mirë kur ata janë pjesëmarrës aktivë në procesin e të mësuarit. | ➔ | Kufizimi i ligjëratave dhe mundësimi i ndarjes së përvojave, pyetjeve dhe ushtrimeve që i shpiejnë pjesëmarrësit të ushtrorinë ndonjë aftësi ose t'a zbatojnë diturinë e fituar. |
| Sa më e rëndësishme është tema për studentin, aq më i suksesshëm është të mësuarit. | ➔ | Shpjegim për shkakun se përse duhet të mësojnë diçka, ndërlidhja e mësimit me përgjegjësit e tyre dhe aktivitetet. |
| Të rriturit kanë nevojë për integrim të diturive të reja me atë që e dinë nga më parë. | ➔ | tempo |
| Të rriturit preferojnë mësime me vetëdrejtim dhe me temon e vete. | ➔ | Nëqoftëse trajnimi zhvillohet në grup, duhet të mbahen edhe aktivitete individuale. |
| Të rriturit mësojnë në mënyrë më efektive kur kanë përgjigje kthyesë dhe mbështetje në mësime. | ➔ | Fidbek i mundshëm nga ana e nxënësve të tjerë dhe trajnuesit |
| Të rriturit mësojnë më mirë në rethinë e cila është joformale dhe personale. | ➔ | Promovimi i interaktivitetit të hapur në grup. |
| Jo krejt të rriturit mësojnë në të njëjtën mënyrë. | ➔ | Që të ketë hapësirë për stile të ndryshme të mësimit me anë të metodave të ndryshme, me teknika audio-vizuale dhe kinetike. |

Në punën me nxënësit duhet që të shmangen detyrat që ata do të kishin përjetuar si shumë të vështira, për shkak se ata mund të ndikojnë negativisht në motivimin e tyre për të mësuar. Detyra të tilla mund t'i frustronjë nxënësit, t'a rrisin nervozën dhe irritimin apo të ndikojnë mbi nxënësit që plotësisht t'a braktisin mësimin. Sipas Vigotskit, Tvisit dhe Hodsonit (Vygotsky, Twiss & Hodgson 2008) të mësuarit është më produktiv kur nxënësi është në zonën e zhvillimit proksimal (Zona e zhvillimit proksimal - ZOPED), ose kur nxënësi është i angazhuar në detyra të cilat sipas peshës janë pak mbi nivelin e njohurive dhe aftësive të tyre aktuale.

Nëse jeni duke punuar në një grup me nxënës me nivele të ndryshme të njohurive paraprake dhe tempo të mësimin, trajnuesi paraprakisht duhet të përgatit detyra me nivele të ndryshme të vështirësisë. Nxënësit me më pak parnjohuri të mëparshme ose me vështirësi të tjera në mësim duhet të punojnë me mbështetjen e trajnuesit ose të ndonjë nxënësi tjetër i cili e ka zotëruar materialin. Kur nxënësve u jepet punë që është vetëm pak mbi nivelin e tyre të cilën e kanë arritur, ka më shumë gjasa se do të ngelin të motivuar, sepse ata kanë sfidë për punën e detyrës. Në këtë drejtim, në qoftë se ndonjë nxënës arrin rezultate të mira në një fushë të caktuar (shkrim, për shembull) mund t'i jepet mirënjohje me atë që ai do do të emërohet si asistent i grupit.

Mund të ndodhë që nxënësit në klasë të duan të ndajnë informacion / thashetheme nga burgu. Kjo formë e socializimit nuk duhet të jetë e ndaluar, por në qoftë se në bisedën joformale prezantohen gjëra që ndryshojnë nga joadekuate në ilegale (si blerje, përdorim ose importim të drogave narkotike ose mjete të tjera të ndaluara në burgun, planifikimi i një sulmi ndaj një të burgosuri ose plane kriminale pas lirisimit), ose ndonjë gjë që mund të rrezikojë sigurinë dhe kontrollin në INP, për këtë duhet të informohet burgu (Twiss & Hodgson 2008 fq.30-31).

Megjithëse këto situata janë përgjithësisht të rralla, mund të ndodhë që gjatë mësimin të priset atmosfera e punës (grindje mesin të dënuarve, kërcënime, agresivitet). Pavarësisht planifikimit të kujdesshëm, ndjeshmëria për nevojat e nxënësve dhe atmosfera në klasë, INP-ja mund të jetë një mjedis i pakëndshëm për kryerjen e arsimit. Prandaj trajnuesi duhet të ketë të zhvilluar një strategji për de-eskalimit e situatave të mundshme të konfliktit. Disa shembuj të praktikës penologjike janë:

Trajnuesi duhet të zgjidhë me kujdes fjalët dhe tonin që do të përdor me nxënësit. Është mirë që drejtimi ndaj nxënësve të jetë i sigurtë dhe me ndjeshmëri.

Trajnuesi duhet ta përshtat bisedën në nivelin e arsimor dhe fjalorin e nxënësve, pa mos e përdorur zhargonin e tyre, për të cilët është pamjaftueshëm i njohur, dhe shpesh ka një konotacion negativ.

Fjalimi duhet të jetë i ngadalshëm dhe me ton të qetë.

Pyetje të tipit të hapur, pyetje të cilave nuk mund tu përgjigjesh me thjeshtë "po" ose "jo". Poqese, bashkëbiseduesi mendon për përgjigje ndërsa vëmendja e tij është e tërhqur nga atmosfera e tensionuar, kjo krijon hapësirë për deeskalimin e situatës.

Nëse trajnuesi nuk është i sigurt se çfarë bashkëbiseduesi ka dashur të thotë, duhet që të kërkoj risqarim; nuk duhet që të nxirren konkluzione të bazuara në supozime dhe interpretime të lira.

Nuk duhet të lejohen përdorimi i vullgariteteve

Vlerësimi i situatës emocionale, racionale dhe sinqeritetit të bashkëbiseduesit tuaj. Pjesa më e madhe e vlerësimit aktual bazohet në përvojat e kaluara me nxënësin.

– Situata duhet të raportohet te personeli i burgut, për sigurinë e trajnuesit, por edhe të burgosurve të tjerë dhe stafit (përshtatur nga Twiss & Hodgson 2008 fq.32-33)

Edhe pse është vështirë që të vendosen rregulla universale për trajtim në burg, në përputhje me procedurat e ndryshme të sjelljes, praktika e krijuar e personelit dhe të dënuarve, udhëzimet në fjalë duhet të respektohen pa marrë parasysh se në çfarë lloji të INP-së dhe me çfarë grupi të synuar zhvillohet procesi arsimor:

Asnjëherë nuk lehen vetë nxënësit në dhomë pa mbikëqyrje.

- Trajnuesi i cili punon vetëm nuk duhet të lihet vetëm me nxënësit e gjinisë së kundërt. Edhe pse nuk ka shumë gjasa që do të vij deri në sulm / ngacmim, trajnuesi duhet të mbrohen nga akuzat e mobingut.

- Poqese veshet pajisje për alarmim të shërbimeve, duhet të testohet funksionaliteti para çdo ore mësimore.

- Personeli i burgut duhet gjithmonë të jetë i informuar për vendndodhjen e trajnuesit në institucion.

- Trajnuesi duhet të përmbahet nga ndarja e informatave personale me grupin dhe të mbajë një distancë profesionale me nxënësit.

- Është e papërshtatshme të pyeten nxënësit për shkeljet e tyre, paditë, mosmarrëveshjet me të burgosurit e tjerë dhe kështu me radhë.

- Çdo sjellje që paraqet kërcënim për sigurinë dhe sigurinë institucionale, sigurinë e individëve duhet të raportohet te shërbimet e burgut.

- Në qoftë se trajneri është një duhanpirës, ai nuk duhet me vete ti mbajë cigare, shkrepsë dhe qibrita.

- Është e dëshirueshme që trajnuesi ta njeh kulturën e burgut - besimet, imperativet. Në raste të caktuara kjo njohuri do të lehtësojë interpretimin dhe parashikimin e sjelljes së nxënësve (përshtatur nga Twiss & Hodgson 2008 fq.17-18).

Përfundim

Arsimi paraqet një element të rëndësishëm në procesit e resocializimit të personave të cilët janë duke shërbyer dënimin me burg. Megjithatë, duke pasur parasysh kufizimet e shumta të llojeve të ndryshme (materiale, administrative, eksperte), kjo komponent e resocializimit paraqet një sfidë të veçantë për të gjitha grupet e interesuara. Nga njëra anë, arsimi është njëra nga të drejtat themelore të njeriut, por duke pasur parasysh profilin e përgjithshëm arsimor të popullatës së burgut, arsimi paraqet parakusht të rëndësishëm për riintegrimin e suksesshëm të të dënuarve në shoqëri dhe zvogëlimin e shkallës së recidivizmit.

Në përgjithësi, organizimi i aktivitetit arsimor në INP zhvillohet me vështirësi në shumicën e vendeve, ku përjashtim nuk është as edhe Republika e Maqedonisë. Rishikimi i arritjeve arsimore të të dënuarve tregon se më shumë se gjysma e tyre janë me arsim fillor ose arsim të paplotë fillor, që nënkupton një nevojë të fortë për programet e shkrim-leximit dhe aftësive themelore. Në këtë drejtim, INP-të në vendin tonë, përballen me një sërë problemesh që pengojnë zbatimin e arsimit fillor dhe të mesëm, i cili është gjithashtu një detyrim ligjor. Shumica e aktiviteteve arsimore organizohen nga sektori qytetar dhe organizatat donatore. Megjithatë, këto projekte nuk mund dhe nuk duhet të zëvendësojnë veprimtarinë e vazhdueshme arsimore në INP. Sfidat për zbatimin efektiv të arsimit dhe trajnimit janë të shumta: nga mungesa e kapacitetit të ambienteve (ka problem shumëvjeçar me stërbushjen e kapaciteteve, që çon deri në ripërdorim dhe përshtatje të atyre hapësira tashmë të adaptuara për mësim edhe për pranimin e të dënuarve), deficit të personelit, mungesa e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të personelit të burgut në fushën e andragogjisë penologjike etj.

Megjithatë, projektet e realizuara tregojnë se ekziston interesim i madh për arsim në mesin e të dënuarve, drejtorja e INP-së dhe institucionet e tjera relevante kërkojnë krijimin e kushteve për zhvillimin e vazhdueshëm të procesit arsimor. Në vitet e fundit, arsimi është vendosur në listën e prioriteteve strategjike në zhvillimin e sistemit penitenciar në vend.

Në aspektin e dizajnit dhe realizimit të programeve arsimore në INP, mund të konstatohet se ky proces nuk mund ti nënshtrohet standardizimit. INP-ja paraqet një sërë kufizimesh dhe sfidash për zhvillimin e suksesshëm të procesit arsimor. Prosesi arsimor në këto institucione zhvillohet nën ndikimin e disa faktorëve, të cilat pavarësisht sistemit formal, janë subjekt i modifikimeve nga njëri institucion në tjetrin. Në këta faktorë hyjnë rutina e burgut, rregullat e sigurisë, marrëdhëniet midis shërbimit të burgjeve, trajnuesit, të dënuarit dhe ngjashëm. Në këtë aspekt arsimit në burgje është objekt i një diapazoni të gjërë të përmbajtjeve të natyrës

organizative dhe edukative. Fleksibiliteti në aspektin e metodave dhe mjeteve për kryerjen e programit, nuk vlejnë për qëllimet e programit, apo kompetencat që pjesëmarrësit duhet ti fitojnë, se kjo do të çaktivizoj verifikimin zyrtar të rezultateve të programit.

Një aspekt i rëndësishëm i arsimit dhe trajnimit që shpesh është i neglizhuar është komponenti i saj arsimor. Në këtë drejtim, potenciali arsimor për transformimin personal e të dënuarit, duhet të mbështes procesin e përgjithshëm të resocializimit, përvetësimit të vlerave dhe aftësive që do të lehtësojnë riintegrimin e individit pas lëshimit në liri. Kjo qasje holistike për arsimin të çon në bashkëpunim të nevojshëm ndërmjet organizatorit të arsimit, drejtorisë së burgut, por edhe personat e përfshirë drejtpërdrejtë në punën me të dënuarit - edukatorët dhe trajnuesit.

Një faktor shtesë në hartimin e programit arsimor është periudha në të cilën zbatohet mësimi. Efekt më të drejtpërdrejtë do të ketë edukimi / trajnimi që zbatohet drejtëpëdrejtë ose pak para lëshimit në liri, me qëllim që personi të jenë të trajnuar në aplikimin e njohurive dhe aftësive. Në rrethana ku programi arsimor realizohet shumë më herët, duhet që të sigurohen kushte të nevojshme që i burgosuri të jetë në gjendje të aplikojë aftësitë e mësuara (nëpërmjet kryerjes së detyrave punuese). Në këtë drejtim, mundësia për punë praktike në INP, apo se çfarë lloje detyrave punuese ekzistojnë fare, apo janë të mundshme në INP, mund të jetë një faktor i rëndësishëm në zgjedhjen e trajnimit për të dënuarin.

Në përputhje me dokumentet ndërkombëtare, në procesin e përzgjedhjes së programeve të caktuara arsimore dhe trajnimeve, përparësi duhet t'u jepet të dënuarve të cilët nuk kanë asnjë lloj arsimit ose arsim fillor të pakompletuar, dmth. ata të dënuar që kanë nevojë për programe të shkrim-leximit. Gjithashtu, duhet të merren parasysh edhe mundësitë që ofrohen në INP-të e tjera (programe arsimore, programe për trajnimi profesional) me qëllim që arsimimi i të dënuarit të mos ndërpritet në rast të zhvendosjes së tij nga njëri INP në tjetrin, si dhe mundësitë për vazhdimin e arsimit pas lëshimit në liri.

Procesi i planifikimit të procesit arsimor, sidomos kur është fjala për futjen e një procesi të ri (përmes projektit) në INP, si dhe zbatimi i procesit të edukimit ose trajnimit paraqet një proces të gjatë. Zgjidhjet afatshkurtra nuk janë në favor të efektivitetit të procesit arsimor.

Dizajni i suksesshëm i programeve për arsim duhet të marrë parasysh njohuritë ekzistuese dhe aftësitë, dhe interesat e të dënuarve. Motivimi i grupit të synuar mund të paraqet një problem në qoftë se marrim parasysh se një pjesë e madhe para kohe e kanë lëshuar shkollën dhe kanë përvoja të këqija nga arsimi i mëparshëm. Në këtë aspekt të burgosurve duhet tu spjegohet se si edukimi / trajnimi të korrespondoj me qëllimet e tyre individuale. Mundësia për akreditim dhe me atë verifikim të njohurive dhe aftësive të fituara, paraqet një motiv të rëndësishëm për shumicën e të dënuarve që ti qasen procesit të edukimit / trajnimit.

Parimi i standardizimit shpesh tregohet si i papërshtatshëm në aspektin e arsimit dhe trajnimit në INP. Është domosdoshme që nevojat e nxënësve të vendosen në qendër të procesit arsimor. Në këtë drejtim, një qasje e individualizuar, e cila i reflekton nevojat e ndryshme të të dënuarve, por edhe i respekton njohuritë dhe aftësitë e tyre të mëparshme dhe jep rezultate optimale. Përshtatshmëria referohet edhe në aspektet e tjera të procesit arsimor, si dhe, gjatësia e programit, dinamika e programit, sipas nevojave specifike të grupit të synuar. Në këtë kontekst, fleksibiliteti është vënë në funksion të nevojës që pjesëmarrësit me motivime të ndryshme, paranjohuri dhe angazhim, të jenë në gjendje që të fitojnë kompetencat përkatëse.

Një aspekt i rëndësishëm i efektivitetit të arsimit është edhe përgatitja e personelit relevant të INP-së, me qëllim që të sigurohet mbështetje në realizimin e programit, por edhe që pjesëmarrësit të jenë aktiv në procesin arsimor (vlerësim i nevojave, planifikimi). Një nga faktorët kryesorë për zbatimin e suksesshëm të programit arsimor është trajnuesi, i cili e përfaqëson, aplikon programin dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë është i ekspozuar drejt kufizimeve dhe sfidave në zbatimin e mësimdhënies / trajnimit në mjedisin e burgut. Në këtë aspekt, është e nevojshme përgatitje e tërësishme e personit i cili do ta realizojë programin, me qëllim që të tejkalohen barrierat psikologjike apo paragjykimet, por edhe të mundësohet të zbatohet metodat andragogjike të përshtatura me kushtet dhe grupin e synuar (përshtatje të përmbajtjeve, alternativa të metodave arsimore dhe mjeteve që janë të papërshtatshme për mjedisin dhe kështu me radhë.). Njohja e sistemit formal në INP dhe bashkëpunimi me menaxhmentin dhe personelin e institucionit, është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e funksionimit normal të procesit arsimor ..

Bibliografija

- Avramovska, M., & Schweighöfer, B. (2011). Where Time Doesn't Pass – Skills Training in Tetovo Prison in Macedonia. *Adult Education and Development*, 77, 151–156. Retrieved from <http://anafae.af/wp-content/uploads/2016/09/DVV-AED-77-Non-Formal-Skill-Training.pdf>.
- Braggins, J., & Talbot, J. (2003). *Time to Learn: Prisoners' Views on Prison Education*. Prison Reform Trust.
- Costelloe, A. (2015). Learning for Liberation, Teaching for Transformation: Can Education in Prison Prepare Prisoners for Active Citizenship? *Irish Journal of Applied Social Studies*, 14(1), 1393–7022. Retrieved from <http://arrow.dit.ie/ijass/vol14/iss1/4>.
- Council of Europe. (1990). *Recommendation No. R (89) 12 adopted by the Council of Ministers of the Council of Europe on 13 October 1989*. Retrieved from [http://pjp-eu.coe.int/documents/3983922/6970334/CMRec+\(89\)+12+on+education+in+prison.pdf/9939f80e-77ee-491d-82f7-83e62566c872](http://pjp-eu.coe.int/documents/3983922/6970334/CMRec+(89)+12+on+education+in+prison.pdf/9939f80e-77ee-491d-82f7-83e62566c872).
- Council of Europe. (2006). *European Prison Rules*. Retrieved from http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/PCCP_documents_2015/EUROPEAN_PRISON_RULES.pdf.
- Council of Europe. (2011). *Council Resolution on a renewed European agenda for adult learning*. Retrieved from <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2011:372:0001:0006:en:PDF>.
- Czerwinski, Tania; König, Eva; Zaichenko, T. (Ed.). (2014). *Youth and Adult Education in Prisons: Experiences from Central Asia, South America, North Africa and Europe*. Bonn: DVV International.
- Department for Business Innovation and Skills. (2011). *Making Prisons Work: Skills for Rehabilitation*. Department for Business, Innovation and Skills. Retrieved from https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/230260/11-828-making-prisons-work-skills-for-rehabilitation.pdf.
- Directorate General for Education and Culture. (2011). *Prison education and training in Europe - a review and commentary of existing literature, analysis and evaluation*. GHK. Retrieved from http://ec.europa.eu/justice/news/consulting_public/0012/Fullreport_en.pdf.
- Hawley, J., Murphy, I., & Souto-Otero, M. (2013). *Prison Education and Training in Europe Current State-of-Play and Challenges*.
- Kamp, M. (2011). *Facilitation Skills and Methods of Adult Education: A Guide for Civic Education at Grassroots Level*. Konrad-Adenauer-Stiftung. Retrieved from http://www.kas.de/wf/doc/kas_29778-1522-2-30.pdf?111219190922.
- Knowles S., M., Holton F. E., & Swanson A. R. (2005). *The Adult Learner* (6th ed.).

Burlington: Elsevier.

Macanović, N., & Nadarević, D. (2014). *Penološka andragogija*. Banja Luka: Evropski defendologija centar za naučna, politička, ekonomska, socijalna, bezbjednosna, sociološka i kriminološka istraživanja. Retrieved from <http://www.defendologija.com/pdf/penoloska-andragogija.pdf>.

Rogers, L., Simonot, M., & Nartey, A. (2014). *Prison Educators: Professionalism Against the Odds*. Retrieved from http://www.ucu.org.uk/media/6179/Prison-education-professionalism-against-the-odds-Feb-14/pdf/prisoneducators-fullreport_feb14.pdf.

Twiss, D., & Hodgson, P. (2008). *Orientation Guide for Corrections Educators*. Retrieved from <http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:http://en.copian.ca/library/learning/orientation/orientation.pdf>.

UN General Assembly. (1991). *Basic Principles for the Treatment of Prisoners: resolution*. Retrieved from <http://www.refworld.org/docid/48abd5740.html>.

United Nations and UNESCO Institute for Education. (1995). *Basic Education in Prisons*. Retrieved from <http://unesdoc.unesco.org/images/0011/001116/111660eo.pdf>.

United Nations Specialised Conferences. (1955). *Standard Minimum Rules for the Treatment of Prisoners*. Retrieved from <http://www.refworld.org/docid/3ae6b36e8.html>.

Закон за основното образование (Сл. Весник на Р. Македонија бр.103/08 од 19.08.2008 година). (2008).

Закон за средното образование консолидиран текст („Службен весник на Република Македонија“ бр. 44/1995; 24/1996; 34/1996; 35/1997; 82/1999; 29/2002; 40/2003; 42/2003; 67/2004; 55/2005; 113/2005; 35/2006; 30/2007; 49/2007; 81/2008; 92/2008; 33/2010; 116/20). (2013).

Министерство за правда. (2010). *Стратегија за ресоцијализација и социјална адаптација на затворени лица кои издржуваат казна затвор 2010-2012*.

Народен правобранител на Република Македонија. (2016a). *Годишен извештај 2015 година - Национален превентивен механизам*. Retrieved from http://www.ohchr.org/Documents/HRBodies/OPCAT/NPM/NPM_FormerMacedonia2015.pdf.

Народен правобранител на Република Македонија. (2016b). *Посебен извештај за општите состојби во однос на остварување правата на жените кои се на издржување казна затвор во КПД „Идризово“*. Скопје.

Национална стратегија за развој на пенитенцијарниот систем (2015-2019). (2014).

Управа за извршување на санкциите. (2009). *Годишен извештај на Управата за извршување на санкциите за состојбата и работењето на казнено-поправните и воспитно-поправните установи во Република Македонија за*

2008 година. Retrieved from
http://www.pravda.gov.mk/documents/God_izvestaj UIS-2008 za na WEB.pdf.

Управа за извршување на санкциите. (2016). *Годишен извештај на Управата за извршување на санкциите за состојбата и работењето на казнено-поправните и воспитно-поправните установи во Република Македонија за 2015 година.*

Kuadro I (aneks). Lista e të anketuarve

| Ред. бр. | Pjesëmarrës | Data e intervjuimit | Institucioni ndëshkues-përmisues |
|----------|---|---------------------|----------------------------------|
| 1. | Pjesëmarrës në trajnimin për bukëpjekës | 27.3.2017 | Burgu Tetovë |
| 2. | Këshilltar në burgun në Tetovë | 27.3.2017 | Burgu Tetovë |
| 3. | Këshilltar në burgun në Tetovë | 27.3.2017 | Burgu Tetovë |
| 4. | Drejtor në burgun në Tetovë | 27.3.2017 | Burgu Tetovë |
| 5. | Pjesëmarrës në trajnimin për bukëpjekës | 24.3.2017 | SHNP Shtip |
| 6. | Pjesëmarrës në trajnimin për bukëpjekës | 24.3.2017 | SHNP Shtip |
| 7. | Drejtor në sektorin për resocializim në INP Shtip | 24.3.2017 | SHNP Shtip |
| 8. | Edukator në INP Shtip | 24.3.2017 | SHNP Shtip |
| 9. | Edukator në INP Shtip | 24.3.2017 | SHNP Shtip |
| 10. | Aleksandra Timosievska Instituti për zhvillim të komunitetit | 24.3.2017 | |
| 11. | Andrijana Tomovksa, trajnes | 28.3.2017 | Burgu Tetovë |
| 12. | Bekim Bajrami, trajnes | 28.3.2017 | Burgu Tetovë |
| 13. | Kiril Ristovski, trajnes | 28.3.2017 | Burgu Tetovë |
| 14. | Bllagoja Mirçevski, trajnes | 28.3.2017 | Burgu Tetovë |
| 15. | Snezhana Danillova, trajnes | 28.3.2017 | Burgu Tetovë |
| 16. | Angellçe Stefanov, trajnes | 28.3.2017 | SHNP Shtip |
| 17. | Biljana Zdraveva, trajnes | 28.3.2017 | SHNP Shtip |
| 18. | Blagorodna Vasileva, trajnes | 28.3.2017 | SHNP Shtip |
| 19. | Marija Trajkovska, trajnes | 28.3.2017 | SHNP Shtip |
| 20. | Viktorija Andova- Golubova, trajnes | 29.3.2017 | SHNP Shtip |
| 21. | Igor Nikollov, dizajner i kurrikulës | 28.3.2017 | |

| | | | |
|-----|---|-----------|--|
| 22. | Olivera Stefanovska, dizajner i kurrikulēs | 28.3.2017 | |
| 23. | Svetlana Petrova, dizajner i kurrikulēs | 28.3.2017 | |
| 24. | Vasil Grozdanovski, dizajner i kurrikulēs | 28.3.2017 | |